# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2019 – Numri: 110

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 29 korrik 2019**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 17.7.2019 | Për një shtesë në vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", të ndryshuar...................................................... | 8147 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 25.7.2019 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 246, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2019" .......................................................... | 8147 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 25.7.2019 | Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin "Ofrimi i shërbimeve me në qendër qytetarin" ......................................... | 8148 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 25.7.2019 | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin "Fondi për studime dhe ekspertë" ....................................................................................... | 8150 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 25.7.2019 | Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira.................................................................................................................... | 8152 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 25.7.2019 | Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020–2022.................................................................... | 8155 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 25.7.2019 | Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa", sh.p.k., si qiramarrës, për pronën nr. 338, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 5012/20", me vendndodhje në Çekrez, Gramsh, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes........................................................................................................... | 8161 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 527 , datë 25.7.2019 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar........................................................................................ | 8171 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 25.7.2019 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin "Qendra e shërbimit dhe administrimit të mjeteve të transportit" ........................................................ | 8172 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 25.7.2019 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë, te Ministria e Brendshme, të pasurive nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4122.56 $m^2$, rruga "Hamdi Pepa", Tiranë........................................................................... | 8173 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 25.7.2019 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 460, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë"... | 8190 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 25.7.2019 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Studim-projektim, masa inxhinierike Buzuq-Çorovodë" ........................ | 8190 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 25.7.2019 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim i bllokut të banimit në lagjen 'Xhevdet Nepravishta', kufizuar me rrugën 'Ahmet Zogu', rrugën 'Misto Mame' dhe shëtitoren 'Kongresi', Lushnjë".. | 8193 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 25.7.2019 | Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror................................................ | 8194 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.7.2019 | Për një ndryshim në vendimin nr. 42, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", të ndryshuar.................................................................................................. | 8197 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 25.7.2019 | Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse në njësinë administrative Topojë, qarku Fier, nga shoqëria "*Max Energy*", sh.p.k. ......................................... | 8198 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 25.7.2019 | Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit.................................................................................................. | 8199 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 25.7.2019 | Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve.... | 8207 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 25.7.2019 | Për miratimin e masave të nevojshme për mbajtjen e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit nga çdo person fizik a juridik, që prodhon, përpunon, trajton dhe shet lëkurë................................................................ | 8208 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 25.7.2019 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 137, datë 28.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për ngritjen e Task-Forcës për evidentimin e pasurive të paluajtshme shtetërore gjatë bregdetit shqiptar, me qëllim investimin në turizmin bregdetar" ............................................................. | 8214 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 17.7.2019 | Për kalimin në pronësi të bashkisë Tiranë të pasurisë nr. 1/644, zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Drejtësisë dhe kalimin në përgjegjësi administrimi, nga bashkia Tiranë te Ministria e Drejtësisë, të pasurisë nr. 5/626, zona kadastrale nr. 8160, Tiranë, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.8.2013, dhe nr. 219, datë 21.3.2017, të ndryshuar............. | 8214 |

**VENDIM**
**Nr. 515, datë 17.7.2019**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.502, DATË 13.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË BRENDSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës "ë", të pikës 3, të vendimit nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja "f", me këtë përmbajtje:

"f) Parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.".

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 517, datë 25.7.2019**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 246, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2019"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 246, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën "a", të pikës 2, shifra: "... 13 ..." bëhet: "... 15 ...".

2. Në pikën 3, fjalët: " ... gjithsej 13, ..." zëvendësohen me: " ... gjithsej 15, ...".

3. Në ndarjen I, "Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr.1, që përmendet në pikën 3, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

"14. Drejtor i Huamarrjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë – kategoria II-b;

15. Drejtor i Drejtorisë së Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile- kategoria II-b.".

4. Në ndarjen II, "Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr.1 që përmendet në pikën 3, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Emërtesat e përmendura në pikat 27 deri në 31, zëvendësohen, si më poshtë vijon:

"27. Kryetar, Dega Doganore Kakavijë, kategoria III-a;

28. Kryetar, Dega Doganore Rinas, kategoria III-a;

29. Kryetar, Dega Doganore Shkodër, kategoria III-a;

30. Kryetar, Dega Doganore Kukës Morinë, kategoria III-a;

31. Drejtor, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave", kategoria III-a;".

Pas pikës 35, shtohen pikat 36 dhe 37, me këtë përmbajtje:

"36. Përgjegjës i sektorit të lajmeve ekonomike dhe politike, në Drejtorinë e Lajmeve dhe Multimedias, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare - kategoria: III-a/1;".

"37. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe i Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural – kategoria: III-a.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr.519, datë 25.7.2019**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR PROJEKTIN "OFRIMI I SHËRBIMEVE ME NË QENDËR QYTETARIN"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin "Ofrimi i shërbimeve me në qendër qytetarin", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

BANKA BOTËRORE
IBRD-IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 10200
LINDA VAN GELDER
Drejtor rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

28 shtator 2018

SH. SË TIJ Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri

I nderuar z. Ministër,

Republika e Shqipërisë: Projekti Ofrimi i Shërbimeve me në Qendër Qytetarin
Huaja nr. 8521-AL
Rialokimi i fondeve ndërmjet kategorive të shpenzimeve

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) të datës 23 shtator 2015, për projektin e lartpërmendur.

Në vijim të kërkesës Tuaj të datës 28 qershor 2018, kemi kënaqësinë t'Ju informojmë se Banka Botërore bie dakord për rialokimin e fondeve të parashikuara për kategorinë tre (3) të shpenzimeve në titullin "Kthimi i paradhënies së përgatitjes së projektit", e cila nuk është disbursuar ende, tek kategoria dy (2) e projektit nën titullin "Mallra, punimeve, shërbime, jokonsulente dhe shërbime të konsulentëve, kostot e trajnimit dhe operative sipas pjesëve 1 (b), 1©, 2(b), 2(c) dhe 3(b) dhe (4) të Projektit".

Tabela në shtojcën 2, Seksioni IV. A.2 të Marrëveshjes së Huas është ndryshuar për rialokimin e fondeve brenda kategorive ekzistuese siç pasqyrohet në shtojcën e kësaj letre.

Sinqerisht
Linda Van Gelder
Drejtor rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni Z. Erjon Luci, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë
Z. Lorin Ymeri, Drejtor Ekzekutiv, ADISA
Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

RCA 248423. WUI 64145. FAX (202) 477-6391
SH. SË TIJ Arben Ahmetaj28 shtator, 2018

SHTOJCË

| Kategoria | Shuma e Huas së Alokuar (e shprehur në euro) | Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar (përfshirë tatimet) |
|---|---|---|
| (1) Programi i shpenzime të miratuara sipas pjesëve 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit | 22,895,000 | 100% deri në shumën e DLI-ve në aneksin 2, të shtojcës 2, të Marrëveshjes |
| (2)Mallra, punime, shërbime jokonsulence, dhe shërbime të konsulentëve, kostot e trajnimit dhe operative sipas pjesëve 1(b), 1(c), 2(b), 2(c) dhe 3(b) dhe (4) të Projektit | 6,326,242.02 | 100% |
| (3) Kthimi i paradhënies së përgatitjes së projektit | 5,507.98 | Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.07 të Kushteve të Përgjithshme |
| (4) Tarifa fillestare | 73.250 | Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme |
| (5) Niveli më i lartë i normës së interesit ose primi i dyshemesë së normës së interesit | | Shuma për t'u paguar në përputhje me seksionin 2.08(c) të kësaj Marrëveshjeje |
| **SHUMA TOTALE** | **29.300.000** | |

Tërheqja e Shumave të Huasë

SH. SË TIJ Arben Ahmetaj28 shtator, 2018

Për dijeni(bcc): Luz Meza-Bartrina, Këshilltar i Lartë, LEGLE
Fabiola Altimari, Këshilltar i Lartë, LEGLE
Darian Dragicevic, Oficer Kredie, WFALA
Njësia e Efektivitetit të Zhvillimit, ECA

**VENDIM**
**Nr. 521, datë 25.7.2019**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018 PËR PROJEKTIN "FONDIPËR STUDIME DHE EKSPERTË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë" me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin "Fondi për studime dhe ekspertë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018 PËR PROJEKTIN "FONDI PËR STUDIME DHE EKSPERTË"

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë:

*në frymën e* marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë,

*duke u nisur* nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë,

*të ndërgjegjshme* se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

*me qëllim* për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

*duke iu referuar* premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 242/2018 datë 17.9.2018)

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

(1) Në zbatim të Marrëveshjes së datës 21 tetor 1988 mbi bashkëpunimin teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të mbështetet projekti i mëposhtëm:

1. Fondi për studime dhe ekspertë (shtim fondesh), nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

(2) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 1.700.000,00 Euro (me fjalë: një milion e shtatëqind mijë euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH).

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1, dhe kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

(4) Një pjesë e premtimit financiar për projektin e Bashkëpunimit Teknik të përmendur në paragrafin 1 në shumën e 300.000,00 (me fjalë: treqind mijë) eurove do të zhvlerësohet pa kompensim në rast se brenda datës 31.12.2018 nuk janë lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit përmendur në nenin 2 dhe eventualisht kontrata e financimit. Për shumën tjetër që mbetet në vlerën e 1.400.000,00 (me fjalë: një milion e katërqind mijë) eurove afati përfundon me mbarimin e datës 31

dhjetor 2022. Nëse kontratat e zbatimit dhe eventualisht të financimit lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2

Hollësirat e projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve, që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projektit në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe eventualisht financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Neni 3

(1) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit, dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

(2) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2.

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimburson, me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane, vlerën e TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin, të mbajtura në këtë kontekst, merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

(4) Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1 paragrafi 1, ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej njërin apo të dy projektet. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, të datës 21 tetor 1988 lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Teknik.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike në çdo kohë; shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës.

3. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë, më.............. në dy origjinale, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDIM**
**Nr. 522, datë 25.7.2019**

## PËR METODIKËN E LLOGARITJES SË MASËS SË QIRASË PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton mënyrën e llogaritjes së qirasë së banesave sociale, që financohen nga buxheti i shtetit dhe/ose i njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Masa e qirasë për banesat sociale, që sigurohen me financime të sektorit privat, përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore, dhe nuk është subjekt i këtij vendimi.

3. Mënyra e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale, e përcaktuar me këtë vendim, u referohet:

a) banesave sociale me qira, që sigurohen nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja;

b) banesave sociale që blihen në treg;

c) objekteve të dala jashtë funksionit, të transformuara në banesa sociale.

4. Masa e qirasë, e shprehur në lekë/m$^2$, llogaritet në varësi të kostos së ndërtimit ose të vlerës së blerjes së banesës në treg. Masa vjetore e qirasë nuk mund të jetë më e madhe se 3% e kostos së ndërtimit ose e vlerës së banesës së blerë në treg.

5. Për llogaritjen e masës së qirasë për banesat sociale që sigurohen nëpërmjet ndërtimeve të reja, në koston e ndërtimit (K) përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit të banimit, të tilla si:

a) vlera e investimit për ndërtimin e ndërtesës;

b) vlera e plotë e projektit teknik;

c) kostoja e blerjes së tokës, kur ajo nuk është pronë e njësisë së vetëqeverisjes vendore;

ç) vlera e investimit për lirimin e sheshit të ndërtimit;

d) vlera e mbikëqyrjes së punimeve;

dh) taksat, tatimet dhe tarifat e aplikueshme gjatë ndërtimit të objektit;

e) kostot e menaxhimit të zbatimit të projektit;

ë) kostot për kolaudimin dhe ato për tarifën e regjistrimit të pronës në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

6. Në koston e ndërtimit, sipas pikës 5, nuk përfshihen:

a) vlera e truallit, kur investimi është bërë në truall, pronë e njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës, si ujësjellës, kanalizime, telefoni, energji elektrike;

c) vlera e investimit për katet e para, kur këto nuk janë të parashikuara për banesa sociale;

ç) taksat, tatimet dhe tarifat vendore, të cilat, për projektin në fjalë, mund të jenë konsideruar si kontribut i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

7. Për objekte të dala jashtë funksionit, të përshtatura në banesa sociale, masa e qirasë llogaritet mbi vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre. Në këtë vlerë përfshihen:

a) vlera kapitale e transferuar e objektit (siç pasqyrohet në regjistrin e kontabilitetit), duke llogaritur edhe shkallën e amortizimit për shkak të përdorimit normal dhe të zakonshëm të tij;

b) kostoja e ndërhyrjes/investimit për përshtatjen e tyre në banesë sociale;

c) tarifa për regjistrimin e pasurisë;

ç) çdo shpenzim tjetër, i kryer me financime të buxhetit të shtetit ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

8. Për llogaritjen e masës së qirasë mujore për çdo apartament, veprohet si më poshtë vijon:

a) Fillimisht llogaritet qiraja e përgjithshme vjetore për të gjithë objektin (Qvtotal), duke shumëzuar me 3% koston totale që ka dalë nga llogaritjet sipas pikave 5, 6 ose 7;

b) Llogaritet përqindja (P) që zë sipërfaqja e çdo apartamenti ndaj sipërfaqes totale të ndërtimit;

c) Përqindja, që rezulton nga ky veprim, shumëzohet me vlerën e përgjithshme vjetore të qirasë, llogaritur sipas shkronjës "a";

ç) Vlera, që rezulton nga veprimi sipas shkronjës "c", pjesëtohet me numrin 12.

Shtojca "A", që i bashkëlidhet këtij vendimi, paraqet një shembull për llogaritjen e qirasë mujore të një apartamenti në një godinë të re banimi social.

9. Për banesat sociale që blihen në treg, masa e qirasë llogaritet në bazë të vlerës së blerjes së banesës në treg. Në këtë vlerë përfshihen:

a) vlera e investimit për blerjen e banesës;

b) shpenzimet për riparime;

c) kostoja për regjistrimin e pronës;

ç) taksat dhe tarifat e aplikueshme;

d) çdo shpenzim tjetër i paparashikuar.

10. Në rastin kur në katet e para të objektit të ndërtuar janë parashikuar mjedise shërbimi, qiraja e tyre, në varësi të destinacionit, mund të përcaktohet sipas nivelit të qirave të objekteve të ngjashme në treg.

11. Për çdo objekt të ri që ndërtohet, adaptohet ose blihet në treg, masa e qirasë llogaritet vetëm një herë dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky nivel qiraje përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës. Çdo vit, niveli i qirasë së miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shumëzohet me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

12. Për çdo njësi banimi, zyrat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore mbajnë evidenca të plota, sipas formularit tip, me shpjegimet përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi në shtojcën "B".

13. Të ardhurat, që mblidhen nga qiratë, derdhen në një llogari të veçantë, të çelur me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në një bankë të nivelit të dytë ose në degën e thesarit, duke përcaktuar, për çdo rast, përgjegjësitë e entit menaxhues dhe të strukturave përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore për mënyrën e përdorimit, të raportimit e të kontrollit të përdorimit të këtyre të ardhurave.

14. Vendimi nr.260, datë 24.2.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave", shfuqizohet.

15. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Shtojca A**

PËR LLOGARITJEN E NIVELIT MAKSIMAL TË QIRASË SË NJË APARTAMENTI NË NJË GODINË TË RE BANIMI SOCIAL

Për llogaritjen e nivelit maksimal të qirasë, sipas pikës 8 të këtij vendimi, për një objekt të ri, jepet shembulli, si më poshtë vijon:

a) Kostoja e përgjithshme e ndërtimit, sipas pikës 2, të këtij vendimi, është:

**K** = 95 155 001.00 lekë;

b) Qiraja vjetore për të gjithë objektin është:

**Qvtotal** = K x 3% = 2 854 650 lekë;

c) Qiraja mujore për të gjithë objektin është:

**Qmtotal = Qvtotal** / 12 = 237 888 lekë;

ç) Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit është: S = 3 370 $m^2$;

d) Sipërfaqja e një apartamenti tip 1 është: S1 = 55,25 $m^2$;

dh) Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj totalit është:

**P** = 55 25/3 370 = 1,63%;

e) Qiraja mujore e këtij apartamenti është:

**Qmapartament = P x Qmtotal** = 1 63% x 237 888 = 3 877 lekë.

## Shtojca B

FORMULARI TIP

<table>
<tr><td colspan="10">Njësia e vetëqeverisjes vendore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Viti _______</td><td>Nr. identifikues i pronës</td><td colspan="2"></td><td colspan="3">Sipërfaqja totale e ndërtimit (vetëm për njësitë e banimit)</td><td colspan="2">_________(m²)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Adresa e objektit</td><td colspan="3"></td><td colspan="3">Kostoja totale e ndërtimit</td><td colspan="2">_________(lek)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Enti menaxhues</td><td colspan="3"></td><td colspan="3">Qiraja vjetore totale</td><td colspan="2">_________lek</td></tr>
<tr><td colspan="4">Personi përgjegjës i njësisë së vetëqeverisjes vendore</td><td></td><td colspan="3">Numri total i apartamenteve</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="10">TË DHËNA MBI QIRAMARRËSIN, QIRANË DHE SUBVENCIONIN PËR ÇDO QIRAMARRËS</td></tr>
<tr><th>Nr. ap.</th><th>Emër, atësia, mbiemër</th><th>Kategoria</th><th>Tipi i apartamentit</th><th>Madhësia e familjes (të rritur +fëmijë)</th><th>Treguesi P</th><th>Qiraja mujore sipas ligjit (lek)</th><th>Të ardhurat neto mujore të familjes (lek)</th><th>Qiraja mujore e përballueshme (lek)</th><th>Masa mujore e subvencionit</th></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

**Shpjegime të formularit tip**

a) "Numri identifikues i pronës" është numri i regjistrimit të pronës.
b) "Enti menaxhues" është subjekti i ngarkuar ose i kontraktuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për administrimin e banesave sociale me qira.
c) "Personi përgjegjës i njësisë së vetëqeverisjes vendore" është personi i ngarkuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për të ndjekur çështjet e administrimit dhe mirëmbajtjes së pronës.
d) "Nr. ap." i referohet numrit të apartamentit.
e) "Kategoria" i referohet nenit 34 të ligjit nr. 22/2018.
f) "Tipi i apartamentit" i referohet numrit të dhomave të gjumit të një apartamenti dhe përcaktohet: G – Për tipin "Garsoniere"; 1+1 për apartament me një dhomë gjumi; 2+1 për apartament me dy dhoma gjumi; 3+1 për apartament me tre dhoma gjumi.
g) "Treguesi P" llogaritet sipas shkronjës "b" të pikës 8 të këtij vendimi.
h) "Qiraja mujore reale" përcaktohet sipas pikave 3 - 8 të këtij vendimi.
i) "Qiraja mujore e përballueshme" llogaritet sipas nenit 3, të ligjit nr. 22/2018.
j) "Masa mujore e subvencionit" është diferenca midis kolonave 7 dhe 9.

**VENDIM**
**Nr. 523, datë 25.7.2019**

## PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020–2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020–2022, sipas lidhjes nr. 1, "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# Tabela 1

## Tavanet përfundimtare - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (në 000/LEK)

| | | Viti 2020 | | | | | Viti 2021 | | | | | Viti 2022 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shpenzimet kapitale | | | | | Shpenzimet kapitale | | | | | Shpenzimet kapitale | | | |
| **Kodi** | **Emërtimi i Institucionit/Programit** | **Totali i shp. korrente** | Financim i brendshëm | Financim i huaj | **Totali i shp. kapitale** | **Totali i shpenzimeve buxhetore** | **Totali i shp. korrente** | Financim i brendshëm | Financimi i huaj | **Totali i shp. kapitale** | **Totali i Shpenzimeve buxhetore** | **Totali i shp. korrente** | Financim i brendshem | Financimi i huaj | **Totali i shp. kapitale** | **Totali i shpenzimeve buxhetore** |
| **1** | **Presidenca** | **241,500** | **6,000** | **0** | **6,000** | **247,500** | **241,500** | **6,000** | **0** | **6,000** | **247,500** | **242,000** | **6,000** | **0** | **6,000** | **248,000** |
| 01120 | Veprimtaria e Presidentit | 241,500 | 6,000 | 0 | 6,000 | 247,500 | 241,500 | 6,000 | 0 | 6,000 | 247,500 | 242,000 | 6,000 | 0 | 6,000 | 248,000 |
| **2** | **Kuvendi** | **1,143,160** | **48,000** | **0** | **48,000** | **1,191,160** | **1,143,160** | **48,000** | **0** | **48,000** | **1,191,160** | **1,143,160** | **48,000** | **0** | **48,000** | **1,191,160** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 419,000 | 48,000 | 0 | 48,000 | 467,000 | 419,000 | 48,000 | 0 | 48,000 | 467,000 | 419,000 | 48,000 | 0 | 48,000 | 467,000 |
| 01120 | Veprimtaria Ligjvënëse | 724,160 | 0 | 0 | 0 | 724,160 | 724,160 | 0 | 0 | 0 | 724,160 | 724,160 | 0 | 0 | 0 | 724,160 |
| **3** | **Kryeministria** | **475,000** | **100,000** | **200,000** | **300,000** | **775,000** | **480,000** | **50,000** | **330,000** | **380,000** | **860,000** | **495,000** | **100,000** | **330,000** | **430,000** | **925,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 475,000 | 100,000 | 200,000 | 300,000 | 775,000 | 480,000 | 50,000 | 330,000 | 380,000 | 860,000 | 495,000 | 100,000 | 330,000 | 430,000 | 925,000 |
| **5** | **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** | **4,310,000** | **3,338,900** | **3,772,000** | **7,110,900** | **11,420,900** | **4,382,989** | **3,389,409** | **3,574,946** | **6,964,355** | **11,347,344** | **4,449,500** | **3,419,409** | **4,024,946** | **7,444,355** | **11,893,855** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 390,000 | 65,000 | 0 | 65,000 | 455,000 | 400,000 | 65,000 | 0 | 65,000 | 465,000 | 405,000 | 65,000 | 0 | 65,000 | 470,000 |
| 04220 | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit | 1,320,000 | 275,409 | 447,918 | 723,327 | 2,043,327 | 1,350,989 | 245,409 | 447,918 | 693,327 | 2,044,316 | 1,351,000 | 245,409 | 497,918 | 743,327 | 2,094,327 |
| 04240 | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 710,000 | **1,700,000** | 755,800 | 2,455,800 | 3,165,800 | 715,000 | **1,700,000** | 755,800 | 2,455,800 | 3,170,800 | 720,000 | **1,700,000** | 755,800 | 2,455,800 | 3,175,800 |
| 04250 | Zhvillimi rural duke mbësht. prodh. bujq, blek, agroind dhe market | **1,230,000** | 1,048,491 | 1,895,682 | 2,944,173 | 4,174,173 | 1,250,000 | 1,179,000 | 1,598,628 | 2,777,628 | 4,027,628 | 1,300,000 | 1,179,000 | 1,898,628 | 3,077,628 | 4,377,628 |
| 04860 | Këshillimi dhe informacioni bujqësor | 520,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 540,000 | 525,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 545,000 | 530,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 550,000 |
| 05470 | Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore | 30,000 | 0 | 0 | 0 | 30,000 | 31,000 | 0 | 0 | 0 | 31,000 | 31,500 | 0 | 0 | 0 | 31,500 |
| 04230 | Mbështetje për peshkimin | 110,000 | 230,000 | 672,600 | 902,600 | 1,012,600 | 111,000 | 180,000 | 772,600 | 952,600 | 1,063,600 | 112,000 | 210,000 | 872,600 | 1,082,600 | 1,194,600 |
| **6** | **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** | **4,905,906** | **24,563,111** | **19,568,352** | **44,131,463** | **49,037,369** | **5,462,500** | **25,349,702** | **21,504,406** | **46,854,108** | **52,316,608** | **5,562,500** | **26,489,702** | **20,454,406** | **46,944,108** | **52,506,608** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 615,456 | 13,000 | 0 | 13,000 | 628,456 | 625,100 | 13,000 | 0 | 13,000 | 638,100 | 625,100 | 13,000 | 0 | 13,000 | 638,100 |
| 04520 | Transporti rrugor | 2,000,000 | 16,930,999 | 8,308,132 | 25,239,131 | 27,239,131 | 2,500,000 | 17,673,414 | 8,708,132 | 26,381,546 | 28,881,546 | 2,600,000 | 18,446,414 | 8,008,132 | 26,454,546 | 29,054,546 |
| 04540 | Transporti detar | 110,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 160,000 | 120,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 170,000 | 120,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 170,000 |
| 04550 | Transporti hekurudhor | 410,000 | 350,000 | 1,400,000 | 1,750,000 | 2,160,000 | 412,000 | 350,000 | 1,400,000 | 1,750,000 | 2,162,000 | 412,000 | 400,000 | 1,400,000 | 1,800,000 | 2,212,000 |
| 04560 | Transporti ajror | 20,200 | 85,000 | 0 | 85,000 | 105,200 | 20,300 | 105,000 | 0 | 105,000 | 125,300 | 20,300 | 2,000 | 0 | 2,000 | 22,300 |
| 06370 | Furnizimi me ujë dhe kanalizime | **500,000** | **4,401,840** | 5,530,220 | 9,932,060 | 10,432,060 | **500,000** | **4,400,016** | 6,866,274 | 11,266,290 | 11,766,290 | **500,000** | **4,820,016** | 6,366,274 | 11,186,290 | 11,686,290 |
| 06220 | Menaxhimi i mbetjeve urbane | 700,000 | 2,164,272 | 850,000 | 3,014,272 | 3,714,272 | 700,000 | 2,164,272 | 1,050,000 | 3,214,272 | 3,914,272 | 700,000 | 2,164,272 | 1,200,000 | 3,364,272 | 4,064,272 |
| 04320 | Mbështetje për Energjinë | 100,000 | 300,000 | 3,260,000 | 3,560,000 | 3,660,000 | 102,000 | 300,000 | 3,260,000 | 3,560,000 | 3,662,000 | 102,000 | 300,000 | 3,260,000 | 3,560,000 | 3,662,000 |
| 04430 | Mbështetje për burimet natyrore | 162,000 | 105,000 | 0 | 105,000 | 267,000 | 180,000 | 105,000 | 0 | 105,000 | 285,000 | 180,000 | 105,000 | 0 | 105,000 | 285,000 |
| 04440 | Mbështetje për Industrinë | 257,150 | 85,000 | 0 | 85,000 | 342,150 | 271,000 | 85,000 | 0 | 85,000 | 356,000 | 271,000 | 85,000 | 0 | 85,000 | 356,000 |
| 06180 | Planifikimi urban | 31,100 | 78,000 | 220,000 | 298,000 | 329,100 | 32,100 | 104,000 | 220,000 | 324,000 | 356,100 | 32,100 | 104,000 | 220,000 | 324,000 | 356,100 |
| **10** | **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** | **56,107,353** | **2,127,689** | **1,238,000** | **3,365,689** | **59,473,042** | **57,338,837** | **2,127,689** | **1,238,000** | **3,365,689** | **60,704,526** | **60,367,000** | **1,777,689** | **1,238,000** | **3,015,689** | **63,382,689** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 633,000 | 243,000 | 200,000 | 443,000 | 1,076,000 | 635,000 | 143,000 | 200,000 | 343,000 | 978,000 | 636,000 | 143,000 | 200,000 | 343,000 | 979,000 |
| 01120 | Menaxhimi i shpenzimeve publike | 357,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 362,000 | 464,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 469,000 | 465,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 470,000 |
| 01130 | Ekzekutimi i pagesave të ndryshme | 300,000 | 0 | 0 | 0 | 300,000 | 330,000 | 0 | 0 | 0 | 330,000 | 330,000 | 0 | 0 | 0 | 330,000 |
| 01140 | Menaxhimi i të ardhurave tatimore | 2,580,000 | 633,000 | 0 | 633,000 | 3,213,000 | 2,700,000 | 733,000 | 0 | 733,000 | 3,433,000 | 2,750,000 | 383,000 | 0 | 383,000 | 3,133,000 |
| 01150 | Menaxhimi i të ardhurave doganore | 3,255,000 | 173,220 | 134,100 | 307,320 | 3,562,320 | 3,300,000 | 173,220 | 120,690 | 293,910 | 3,593,910 | 3,450,000 | 173,220 | 120,690 | 293,910 | 3,743,910 |
| 01160 | Lufta kundër transaksioneve | 78,900 | 2,000 | 0 | 2,000 | 80,900 | 79,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 81,000 | 80,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 82,000 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | financiare jo-ligjore | | | | | | | | | | | | | | | |
| 04130 | Mbeshtetje për zhvillim ekonomik | 268,000 | 112,000 | 150,000 | 262,000 | 530,000 | 269,000 | 112,000 | 150,000 | 262,000 | 531,000 | 270,000 | 112,000 | 150,000 | 262,000 | 532,000 |
| 04160 | Mbeshtetje për mbikq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr. | 336,500 | 30,000 | 0 | 30,000 | 366,500 | 337,500 | 30,000 | 0 | 30,000 | 367,500 | 338,000 | 30,000 | 0 | 30,000 | 368,000 |
| 10220 | Sigurimi Shoqëror | 43,888,653 | 0 | 0 | 0 | 43,888,653 | 44,744,337 | 0 | 0 | 0 | 44,744,337 | 47,563,000 | 0 | 0 | 0 | 47,563,000 |
| 10550 | Tregu i punës | 1,800,000 | 151,000 | 0 | 151,000 | 1,951,000 | 1,900,000 | 151,000 | 0 | 151,000 | 2,051,000 | 1,900,000 | 151,000 | 0 | 151,000 | 2,051,000 |
| 04170 | Inspektimi në punë | 180,300 | 10,000 | 0 | 10,000 | 190,300 | 190,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 200,000 | 190,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 200,000 |
| 09240 | Arsimi i Mesëm (profesional) | 2,050,000 | 518,469 | 753,900 | 1,272,369 | 3,322,369 | 2,010,000 | 518,469 | 767,310 | 1,285,779 | 3,295,779 | 2,015,000 | 518,469 | 767,310 | 1,285,779 | 3,300,779 |
| 06190 | Strehimi | 380,000 | 250,000 | 0 | 250,000 | 630,000 | 380,000 | 250,000 | 0 | 250,000 | 630,000 | 380,000 | 250,000 | 0 | 250,000 | 630,000 |
| **11** | **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise** | **38,603,043** | **4,434,000** | **216,000** | **4,650,000** | **43,253,043** | **39,662,000** | **5,234,000** | **300,000** | **5,534,000** | **45,196,000** | **40,776,000** | **5,734,000** | **300,000** | **6,034,000** | **46,810,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 726,000 | 55,000 | 0 | 55,000 | 781,000 | 727,000 | 55,000 | 0 | 55,000 | 782,000 | 780,000 | 55,000 | 0 | 55,000 | 835,000 |
| 09120 | Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin) | 21,800,000 | 1,737,000 | 0 | 1,737,000 | 23,537,000 | 21,650,000 | 1,837,000 | 0 | 1,837,000 | 23,487,000 | 21,700,000 | 1,937,000 | 0 | 1,937,000 | 23,637,000 |
| 09230 | Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm) | 6,477,043 | 1,162,000 | 0 | 1,162,000 | 7,639,043 | 6,480,000 | 1,162,000 | 0 | 1,162,000 | 7,642,000 | 6,490,000 | 1,362,000 | 0 | 1,362,000 | 7,852,000 |
| 09450 | Arsimi Universitar | 9,000,000 | 1,030,000 | 100,000 | 1,130,000 | 10,130,000 | 10,200,000 | 1,330,000 | 100,000 | 1,430,000 | 11,630,000 | 11,200,000 | 1,430,000 | 100,000 | 1,530,000 | 12,730,000 |
| 09770 | Fonde për shkencën | 380,000 | 200,000 | 100,000 | 300,000 | 680,000 | 380,000 | 400,000 | 100,000 | 500,000 | 880,000 | 380,000 | 450,000 | 100,000 | 550,000 | 930,000 |
| 08140 | Zhvillimi i sportit dhe rinisë | 220,000 | 250,000 | 16,000 | 266,000 | 486,000 | 225,000 | 450,000 | 100,000 | 550,000 | 775,000 | 226,000 | 500,000 | 100,000 | 600,000 | 826,000 |
| **12** | **Ministria e Kulturës** | **1,515,000** | **500,000** | **0** | **500,000** | **2,015,000** | **1,525,000** | **500,000** | **0** | **500,000** | **2,025,000** | **1,526,500** | **500,000** | **0** | **500,000** | **2,026,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 170,000 | 0 | 0 | 0 | 170,000 | 185,000 | 0 | 0 | 0 | 185,000 | 185,500 | 0 | 0 | 0 | 185,500 |
| 08220 | Trashegimia Kulturore dhe Muzete | 560,000 | 7,500 | 0 | 7,500 | 567,500 | 550,000 | 7,500 | 0 | 7,500 | 557,500 | 550,500 | 7,500 | 0 | 7,500 | 558,000 |
| 08230 | Arti dhe Kultura | 785,000 | 492,500 | 0 | 492,500 | 1,277,500 | 790,000 | 492,500 | 0 | 492,500 | 1,282,500 | 790,500 | 492,500 | 0 | 492,500 | 1,283,000 |
| **13** | **Ministria e Shëndetësisë** | **60,279,680** | **2,154,000** | **1,110,000** | **3,264,000** | **63,543,680** | **62,102,704** | **2,101,700** | **1,110,000** | **3,211,700** | **65,314,404** | **65,787,704** | **2,101,700** | **1,110,000** | **3,211,700** | **68,999,404** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 465,940 | 18,000 | 0 | 18,000 | 483,940 | 470,000 | 18,000 | 0 | 18,000 | 488,000 | 470,000 | 18,000 | 0 | 18,000 | 488,000 |
| 07220 | Shërbimet e Kujdesit Parësor | 9,026,320 | 429,000 | 158,000 | 587,000 | 9,613,320 | 8,777,300 | 182,000 | 158,000 | 340,000 | 9,117,300 | 9,068,300 | 182,000 | 158,000 | 340,000 | 9,408,300 |
| 07330 | Shërbimet e Kujdesit Dytësor | 22,456,992 | 1,262,409 | 852,000 | 2,114,409 | 24,571,401 | 23,584,976 | 1,383,020 | 852,000 | 2,235,020 | 25,819,996 | 25,584,976 | 1,383,020 | 852,000 | 2,235,020 | 27,819,996 |
| 07450 | Shërbimet e Shëndetit Publik | 3,100,428 | 149,591 | 0 | 149,591 | 3,250,019 | 3,264,428 | 13,680 | 0 | 13,680 | 3,278,108 | 3,264,428 | 13,680 | 0 | 13,680 | 3,278,108 |
| 07460 | Shërbimi Kombëtar i Urgjencës | 350,000 | 225,000 | 0 | 225,000 | 575,000 | 450,000 | 225,000 | 0 | 225,000 | 675,000 | 450,000 | 225,000 | 0 | 225,000 | 675,000 |
| 10430 | Përkujdesi Social | 23,830,000 | 70,000 | 100,000 | 170,000 | 24,000,000 | 24,506,000 | 280,000 | 100,000 | 380,000 | 24,886,000 | 25,900,000 | 280,000 | 100,000 | 380,000 | 26,280,000 |
| 01190 | Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik | 1,050,000 | 0 | 0 | 0 | 1,050,000 | 1,050,000 | 0 | 0 | 0 | 1,050,000 | 1,050,000 | 0 | 0 | 0 | 1,050,000 |
| **14** | **Ministria e Drejtësisë** | **11,325,216** | **592,000** | **225,000** | **817,000** | **12,142,216** | **11,445,100** | **432,000** | **110,000** | **542,000** | **11,987,100** | **11,507,400** | **432,000** | **110,000** | **542,000** | **12,049,400** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 457,000 | 191,800 | 225,000 | 416,800 | 873,800 | 470,000 | 141,800 | 110,000 | 251,800 | 721,800 | 471,000 | 141,800 | 110,000 | 251,800 | 722,800 |
| 03310 | Ndihma juridike | 75,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 77,000 | 78,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 80,000 | 78,500 | 2,000 | 0 | 2,000 | 80,500 |
| 01120 | Publikimet zyrtare | 55,400 | 13,000 | 0 | 13,000 | 68,400 | 53,000 | 13,000 | 0 | 13,000 | 66,000 | 53,500 | 13,000 | 0 | 13,000 | 66,500 |
| 01130 | Mjekesia Ligjore | 81,000 | 11,000 | 0 | 11,000 | 92,000 | 81,300 | 1,000 | 0 | 1,000 | 82,300 | 81,600 | 1,000 | 0 | 1,000 | 82,600 |
| 03440 | Sistemi i Burgjeve | 5,551,916 | 317,000 | 0 | 317,000 | 5,868,916 | 5,610,000 | 217,000 | 0 | 217,000 | 5,827,000 | 5,670,000 | 217,000 | 0 | 217,000 | 5,887,000 |
| 03350 | Sherbimi i Përmbarimit Gjyqesor | 163,100 | 14,000 | 0 | 14,000 | 177,100 | 164,000 | 14,000 | 0 | 14,000 | 178,000 | 164,000 | 14,000 | 0 | 14,000 | 178,000 |
| 01160 | Shërbimet per çështjet e birësimeve | 14,500 | 200 | 0 | 200 | 14,700 | 15,000 | 200 | 0 | 200 | 15,200 | 15,000 | 200 | 0 | 200 | 15,200 |
| 01180 | Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 4,764,000 | 41,000 | 0 | 41,000 | 4,805,000 | 4,810,000 | 41,000 | 0 | 41,000 | 4,851,000 | 4,810,000 | 41,000 | 0 | 41,000 | 4,851,000 |
| 03490 | Shërbimi i Provës | 163,300 | 2,000 | 0 | 2,000 | 165,300 | 163,800 | 2,000 | 0 | 2,000 | 165,800 | 163,800 | 2,000 | 0 | 2,000 | 165,800 |
| **15** | **Ministria e Punëve të Jashtme** | **2,949,600** | **43,000** | **134,780** | **177,780** | **3,127,380** | **2,919,276** | **43,000** | **80,780** | **123,780** | **3,043,056** | **2,941,276** | **43,000** | **80,780** | **123,780** | **3,065,056** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 149,600 | 7,000 | 0 | 7,000 | 156,600 | 150,000 | 7,000 | 0 | 7,000 | 157,000 | 150,500 | 7,000 | 0 | 7,000 | 157,500 |
| 01120 | Mbështetje diplomatike jashtë shtetit | 2,470,000 | 15,000 | 0 | 15,000 | 2,485,000 | 2,433,776 | 15,000 | 0 | 15,000 | 2,448,776 | 2,453,776 | 15,000 | 0 | 15,000 | 2,468,776 |
| 01130 | Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ | 210,000 | 0 | 0 | 0 | 210,000 | 210,500 | 0 | 0 | 0 | 210,500 | 211,000 | 0 | 0 | 0 | 211,000 |
| 01150 | Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit | 120,000 | 21,000 | 134,780 | 155,780 | 275,780 | 125,000 | 21,000 | 80,780 | 101,780 | 226,780 | 126,000 | 21,000 | 80,780 | 101,780 | 227,780 |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **19,065,542** | **890,000** | **818,868** | **1,708,868** | **20,774,410** | **19,269,690** | **890,000** | **818,868** | **1,708,868** | **20,978,558** | **19,346,000** | **890,000** | **818,868** | **1,708,868** | **21,054,868** |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,050,000 | 122,849 | 0 | 122,849 | 1,172,849 | 1,060,000 | 122,849 | 0 | 122,849 | 1,182,849 | 1,062,000 | 122,849 | 0 | 122,849 | 1,184,849 |
| 03140 | Policia e Shtetit | 15,260,542 | 722,151 | 818,868 | 1,541,019 | 16,801,561 | 15,430,690 | 652,151 | 818,868 | 1,471,019 | 16,901,709 | 15,460,000 | 652,151 | 818,868 | 1,471,019 | 16,931,019 |
| 03150 | Garda e Republikës | 1,560,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 1,570,000 | 1,580,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 1,590,000 | 1,585,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 1,595,000 |
| 01160 | Prefekturat dhe funksionet e deleguara të Pushtetit Vendor | 530,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 535,000 | 532,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 537,000 | 540,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 545,000 |
| 01170 | Shërbimi i Gjëndjes Civile | 665,000 | 30,000 | 0 | 30,000 | 695,000 | 667,000 | 100,000 | 0 | 100,000 | 767,000 | 699,000 | 100,000 | 0 | 100,000 | 799,000 |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **20,078,845** | **4,720,000** | **0** | **4,720,000** | **24,798,845** | **21,828,300** | **7,610,500** | **300,000** | **7,910,500** | **29,738,800** | **24,828,300** | **8,910,500** | **3,300,000** | **12,210,500** | **37,038,800** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,189,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 1,209,000 | 1,190,300 | 120,000 | 0 | 120,000 | 1,310,300 | 1,190,300 | 120,000 | 0 | 120,000 | 1,310,300 |
| 02120 | Forcat e Luftimit | 6,065,835 | 4,207,500 | 0 | 4,207,500 | 10,273,335 | 6,880,000 | 5,057,500 | 0 | 5,057,500 | 11,937,500 | 8,380,000 | 5,957,500 | 3,000,000 | 8,957,500 | 17,337,500 |
| 09430 | Arsimi Ushtarak | 600,050 | 0 | 0 | 0 | 600,050 | 620,000 | 0 | 0 | 0 | 620,000 | 620,000 | 0 | 0 | 0 | 620,000 |
| 02150 | Mbështetja e Luftimit | 6,023,410 | 422,500 | 0 | 422,500 | 6,445,910 | 6,782,000 | 1,813,000 | 0 | 1,813,000 | 8,595,000 | 8,282,000 | 1,813,000 | 0 | 1,813,000 | 10,095,000 |
| 07340 | Mbështetje për Shëndetësinë | 845,550 | 50,000 | 0 | 50,000 | 895,550 | 856,000 | 200,000 | 0 | 200,000 | 1,056,000 | 856,000 | 200,000 | 0 | 200,000 | 1,056,000 |
| 10270 | Mbështetje Sociale për Ushtarakët | 5,060,000 | 0 | 0 | 0 | 5,060,000 | 5,200,000 | 0 | 0 | 0 | 5,200,000 | 5,200,000 | 0 | 0 | 0 | 5,200,000 |
| 10910 | Emergjencat Civile | 295,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 315,000 | 300,000 | 420,000 | 300,000 | 720,000 | 1,020,000 | 300,000 | 820,000 | 300,000 | 1,120,000 | 1,420,000 |
| **18** | **Sherbimi Informativ Shteteror** | **1,730,000** | **54,500** | **0** | **54,500** | **1,784,500** | **1,750,000** | **50,000** | **0** | **50,000** | **1,800,000** | **1,550,000** | **50,000** | **0** | **50,000** | **1,600,000** |
| 03520 | Veprimtaria Informative Shteterore | 1,730,000 | 54,500 | 0 | 54,500 | 1,784,500 | 1,750,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 1,800,000 | 1,760,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 1,810,000 |
| **19** | **Drejtoria e Radio Televizionit** | **595,000** | **100,000** | **0** | **100,000** | **695,000** | **618,000** | **50,000** | **0** | **50,000** | **668,000** | **618,000** | **0** | **0** | **0** | **618,000** |
| 08310 | Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit | 270,000 | 0 | 0 | 0 | 270,000 | 280,000 | 0 | 0 | 0 | 280,000 | 280,000 | 0 | 0 | 0 | 280,000 |
| 08520 | Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja | 200,000 | 100,000 | 0 | 100,000 | 300,000 | 210,000 | 50,000 | 0 | 50,000 | 260,000 | 210,000 | 0 | 0 | 0 | 210,000 |
| 08330 | Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare | 65,000 | 0 | 0 | 0 | 65,000 | 65,000 | 0 | 0 | 0 | 65,000 | 65,000 | 0 | 0 | 0 | 65,000 |
| 08340 | Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografisë | 60,000 | 0 | 0 | 0 | 60,000 | 63,000 | 0 | 0 | 0 | 63,000 | 63,000 | 0 | 0 | 0 | 63,000 |
| **20** | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **185,000** | **80,000** | **0** | **80,000** | **265,000** | **186,000** | **5,000** | **0** | **5,000** | **191,000** | **186,000** | **5,000** | **0** | **5,000** | **191,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 185,000 | 80,000 | 0 | 80,000 | 265,000 | 186,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 191,000 | 186,000 | 5,000 | 0 | 5,000 | 191,000 |
| **22** | **Akademia e Shkencës** | **110,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **111,000** | **111,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **112,000** | **111,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **112,500** |
| 01520 | Veprimtaria Akademike | 110,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 111,000 | 111,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 112,000 | 111,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 112,500 |
| **24** | **Kontrolli i Lartë i Shtetit** | **398,000** | **17,000** | **0** | **17,000** | **415,000** | **398,500** | **20,000** | **0** | **20,000** | **418,500** | **399,000** | **20,000** | **0** | **20,000** | **419,000** |
| 01120 | Veprimtaria Audituese e KLSH | 398,000 | 17,000 | 0 | 17,000 | 415,000 | 398,500 | 20,000 | 0 | 20,000 | 418,500 | 399,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 419,000 |
| **26** | **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | **1,370,630** | **420,100** | **490,000** | **910,100** | **2,280,730** | **1,395,000** | **420,100** | **690,000** | **1,110,100** | **2,505,100** | **1,399,000** | **420,100** | **690,000** | **1,110,100** | **2,509,100** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 220,000 | 6,000 | 0 | 6,000 | 226,000 | 225,000 | 6,000 | 0 | 6,000 | 231,000 | 226,000 | 6,000 | 0 | 6,000 | 232,000 |
| 05320 | Programe për mbrojtjen e Mjedisit | 515,000 | 90,000 | 490,000 | 580,000 | 1,095,000 | 525,000 | 90,000 | 690,000 | 780,000 | 1,305,000 | 526,000 | 90,000 | 690,000 | 780,000 | 1,306,000 |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve | 448,000 | 158,600 | 0 | 158,600 | 606,600 | 455,000 | 158,600 | 0 | 158,600 | 613,600 | 456,000 | 158,600 | 0 | 158,600 | 614,600 |
| 04760 | Zhvillimi i Turizmit | 187,630 | 165,500 | 0 | 165,500 | 353,130 | 190,000 | 165,500 | 0 | 165,500 | 355,500 | 191,000 | 165,500 | 0 | 165,500 | 356,500 |
| **28** | **Prokuroria e Përgjithshme** | **1,893,800** | **130,000** | **0** | **130,000** | **2,023,800** | **1,893,800** | **130,000** | **0** | **130,000** | **2,023,800** | **1,893,800** | **130,000** | **0** | **130,000** | **2,023,800** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 1,893,800 | 130,000 | 0 | 130,000 | 2,023,800 | 1,893,800 | 130,000 | 0 | 130,000 | 2,023,800 | 1,893,800 | 130,000 | 0 | 130,000 | 2,023,800 |
| **29** | **Këshilli i Lartë Gjyqësor** | **3,173,150** | **200,000** | **0** | **200,000** | **3,373,150** | **3,173,150** | **200,000** | **0** | **200,000** | **3,373,150** | **4,973,150** | **0** | **0** | **0** | **4,973,150** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 67,150 | 750 | 0 | 750 | 67,900 | 67,150 | 750 | 0 | 750 | 67,900 | 67,150 | 0 | 0 | 0 | 67,150 |
| 03310 | Buxheti Gjyqësor | 3,106,000 | 199,250 | 0 | 199,250 | 3,305,250 | 3,106,000 | 199,250 | 0 | 199,250 | 3,305,250 | 4,906,000 | 0 | 0 | 0 | 4,906,000 |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **160,000** | **4,000** | **0** | **4,000** | **164,000** | **161,000** | **4,000** | **0** | **4,000** | **165,000** | **161,500** | **4,000** | **0** | **4,000** | **165,500** |
| 03320 | Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese | 160,000 | 4,000 | 0 | 4,000 | 164,000 | 161,000 | 4,000 | 0 | 4,000 | 165,000 | 161,500 | 4,000 | 0 | 4,000 | 165,500 |
| **31** | **Agjensia Telegrafike Shqiptare** | **69,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **70,000** | **70,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **71,000** | **71,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **72,500** |
| 08320 | Veprimtaria Telegrafike e ATSH-së | 69,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 70,000 | 70,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 71,000 | 71,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 72,500 |
| **35** | **Këshilli i Lartë i Prokurorisë** | **144,000** | **25,000** | **0** | **25,000** | **169,000** | **144,000** | **10,000** | **0** | **10,000** | **154,000** | **144,000** | **0** | **0** | **0** | **144,000** |
| 01110 | Veprimtaria e KLP | 144,000 | 25,000 | 0 | 25,000 | 169,000 | 144,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 154,000 | 144,000 | 0 | 0 | 0 | 144,000 |
| **40** | **Partite Politike** | **200,000** | 0 | **0** | **0** | **200,000** | **202,600** | **0** | **0** | **0** | **202,600** | **202,600** | **0** | **0** | **0** | **202,600** |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01110 | Mbështetje për Partitë Politike | 190,000 | 0 | 0 | 0 | 190,000 | 191,900 | 0 | 0 | 0 | 191,900 | 191,900 | 0 | 0 | 0 | 191,900 |
| 01120 | Mbështetje për Shoqatat | 8,000 | 0 | 0 | 0 | 8,000 | 8,500 | 0 | 0 | 0 | 8,500 | 8,500 | 0 | 0 | 0 | 8,500 |
| 01130 | Mbështetje për Organizatat e Veteranëve me Status | 2,000 | 0 | 0 | 0 | 2,000 | 2,200 | 0 | 0 | 0 | 2,200 | 2,200 | 0 | 0 | 0 | 2,200 |
| **41** | **Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** | **346,000** | **20,000** | **0** | **20,000** | **366,000** | **346,000** | **10,000** | **0** | **10,000** | **356,000** | **346,000** | **0** | **0** | **0** | **346,000** |
| 01110 | Veprimtaria e SPAK | 346,000 | 20,000 | 0 | 20,000 | 366,000 | 346,000 | 10,000 | 0 | 10,000 | 356,000 | 346,000 | 0 | 0 | 0 | 346,000 |
| **50** | **Instituti i Statistikës** | **1,020,000** | **94,000** | **0** | **94,000** | **1,114,000** | **550,000** | **15,600** | **0** | **15,600** | **565,600** | **550,000** | **15,600** | **0** | **15,600** | **565,600** |
| 01320 | Veprimtaria Statistikore | 1,020,000 | 94,000 | 0 | 94,000 | 1,114,000 | 550,000 | 15,600 | 0 | 15,600 | 565,600 | 550,000 | 15,600 | 0 | 15,600 | 565,600 |
| **55** | **Shkolla e Magjistraturës** | **198,000** | **60,000** | **0** | **60,000** | **258,000** | **198,500** | **60,000** | **0** | **60,000** | **258,500** | **199,000** | **60,000** | **0** | **60,000** | **259,000** |
| 09820 | Veprimtaria Arsimore | 198,000 | 60,000 | 0 | 60,000 | 258,000 | 198,500 | 60,000 | 0 | 60,000 | 258,500 | 199,000 | 60,000 | 0 | 60,000 | 259,000 |
| **56** | **Fondi i Zhvillimit Shqiptar** | **0** | **11,100,000** | **6,402,000** | **17,502,000** | **17,502,000** | **0** | **8,500,000** | **7,260,000** | **15,760,000** | **15,760,000** | **0** | **9,500,000** | **6,860,000** | **16,360,000** | **16,360,000** |
| 06210 | Programe Zhvillimi | 0 | 5,300,000 | 6,402,000 | 11,702,000 | 11,702,000 | 0 | 4,500,000 | 7,260,000 | 11,760,000 | 11,760,000 | 0 | 5,000,000 | 6,860,000 | 11,860,000 | 11,860,000 |
| 06220 | Infrastruktura Vendore dhe Rajonale | 0 | 5,000,000 | 0 | 5,000,000 | 5,000,000 | 0 | 3,000,000 | 0 | 3,000,000 | 3,000,000 | 0 | 3,500,000 | 0 | 3,500,000 | 3,500,000 |
| 04230 | Programi "100 Fshatrat" | 0 | 800,000 | 0 | 800,000 | 800,000 | 0 | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 1,000,000 |
| **57** | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **169,120** | **1,000** | **0** | **1,000** | **170,120** | **170,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **171,000** | **171,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **172,000** |
| 08220 | Mbështetja e veprimtarisë kinematografike | 169,120 | 1,000 | 0 | 1,000 | 170,120 | 170,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 171,000 | 171,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 172,000 |
| **63** | **Institucionet e sistemit të drejtësisë** | **479,400** | **14,000** | **0** | **14,000** | **493,400** | **479,400** | **7,000** | **0** | **7,000** | **486,400** | **478,400** | **6,000** | **0** | **6,000** | **484,400** |
| 03320 | Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë | 90,000 | 7,000 | 0 | 7,000 | 97,000 | 90,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 92,000 | 90,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 92,000 |
| 03330 | Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit | 188,200 | 4,000 | 0 | 4,000 | 192,200 | 188,200 | 2,000 | 0 | 2,000 | 190,200 | 188,200 | 2,000 | 0 | 2,000 | 190,200 |
| 03340 | Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar | 135,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 137,000 | 135,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 137,000 | 135,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 137,000 |
| 03360 | Veprimtaria e komisionerit publik | 66,200 | 1,000 | 0 | 1,000 | 67,200 | 66,200 | 1,000 | 0 | 1,000 | 67,200 | 65,200 | 0 | 0 | 0 | 65,200 |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **117,100** | **2,000** | **0** | **2,000** | **119,100** | **123,000** | **2,000** | **0** | **2,000** | **125,000** | **123,500** | **2,000** | **0** | **2,000** | **125,500** |
| 03320 | Shërbimi i avokatisë | 117,100 | 2,000 | 0 | 2,000 | 119,100 | 123,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 125,000 | 123,500 | 2,000 | 0 | 2,000 | 125,500 |
| **67** | **Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil** | **56,766** | **2,000** | **0** | **2,000** | **58,766** | **58,769** | **2,000** | **0** | **2,000** | **60,769** | **58,800** | **2,000** | **0** | **2,000** | **60,800** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 56,766 | 2,000 | 0 | 2,000 | 58,766 | 58,769 | 2,000 | 0 | 2,000 | 60,769 | 58,800 | 2,000 | 0 | 2,000 | 60,800 |
| **73** | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | **135,600** | **1,500** | **0** | **1,500** | **137,100** | **736,000** | **1,500** | **0** | **1,500** | **737,500** | **136,000** | **1,500** | **0** | **1,500** | **137,500** |
| 01610 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 135,600 | 1,500 | 0 | 1,500 | 137,100 | 136,000 | 1,500 | 0 | 1,500 | 137,500 | 136,000 | 1,500 | 0 | 1,500 | 137,500 |
| 01620 | Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 600,000 | 0 | 0 | 0 | 600,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **76** | **Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** | **140,300** | **3,000** | **0** | **3,000** | **143,300** | **142,600** | **3,000** | **0** | **3,000** | **145,600** | **142,600** | **3,000** | **0** | **3,000** | **145,600** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 140,300 | 3,000 | 0 | 3,000 | 143,300 | 142,600 | 3,000 | 0 | 3,000 | 145,600 | 142,600 | 3,000 | 0 | 3,000 | 145,600 |
| **77** | **Autoriteti i Konkurrencës** | **73,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **74,000** | **73,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **74,500** | **74,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **75,000** |
| 04120 | Mbikqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës | 73,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 74,000 | 73,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 74,500 | 74,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 75,000 |
| **82** | **Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit** | **11,520** | **1,000** | **0** | **1,000** | **12,520** | **11,700** | **1,000** | **0** | **1,000** | **12,700** | **11,700** | **1,000** | **0** | **1,000** | **12,700** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 11,520 | 1,000 | 0 | 1,000 | 12,520 | 11,700 | 1,000 | 0 | 1,000 | 12,700 | 11,700 | 1,000 | 0 | 1,000 | 12,700 |
| **87** | **Institucione të tjera qeveritare** | **4,080,689** | **1,289,200** | **243,000** | **1,532,200** | **5,612,889** | **4,117,423** | **1,240,800** | **243,000** | **1,483,800** | **5,601,223** | **4,170,123** | **1,230,800** | **243,000** | **1,473,800** | **5,643,923** |
| 01320 | Shërbime Qeveritare | 200,000 | 30,000 | 0 | 30,000 | 230,000 | 200,000 | 30,000 | 0 | 30,000 | 230,000 | 200,000 | 30,000 | 0 | 30,000 | 230,000 |
| 01130 | Shërbimi i Prokurimit Publik | 58,800 | 3,000 | 0 | 3,000 | 61,800 | 59,300 | 1,000 | 0 | 1,000 | 60,300 | 59,800 | 1,000 | 0 | 1,000 | 60,800 |
| 01120 | Shërbimi për diasporen | 121,500 | 61,000 | 0 | 61,000 | 182,500 | 123,500 | 61,000 | 0 | 61,000 | 184,500 | 124,000 | 61,000 | 0 | 61,000 | 185,000 |
| 05640 | Administrimi i ujrave | 105,000 | 27,000 | 93,000 | 120,000 | 225,000 | 107,000 | 27,000 | 93,000 | 120,000 | 227,000 | 107,500 | 17,000 | 93,000 | 110,000 | 217,500 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 03310 | Shërbimi i Avokatisë Shtetërore | 218,200 | 2,000 | 0 | 2,000 | 220,200 | 218,300 | 2,000 | 0 | 2,000 | 220,300 | 218,400 | 2,000 | 0 | 2,000 | 220,400 |
| 01150 | Shërbime të tjera | 404,092 | 139,500 | 0 | 139,500 | 543,592 | 404,700 | 83,000 | 0 | 83,000 | 487,700 | 404,800 | 83,000 | 0 | 83,000 | 487,800 |
| 01140 | e-Qeverisja | 2,502,697 | 920,700 | 0 | 920,700 | 3,423,397 | 2,527,123 | 929,800 | 0 | 929,800 | 3,456,923 | 2,577,123 | 929,800 | 0 | 929,800 | 3,506,923 |
| 01330 | Menaxhimi dhe zhvillimi i Administratës Publike | 338,000 | 106,000 | 150,000 | 256,000 | 594,000 | 344,500 | 106,000 | 150,000 | 256,000 | 600,500 | 345,000 | 106,000 | 150,000 | 256,000 | 601,000 |
| 08480 | Mbështetje për Kultet Fetare | 132,400 | 0 | 0 | 0 | 132,400 | 133,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 134,000 | 133,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 134,500 |
| **88** | **Mbështetje për Shoqërinë Civile** | **123,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **124,000** | **124,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **125,000** | **124,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **125,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 123,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 124,000 | 124,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 125,000 | 124,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 125,500 |
| **89** | **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** | **70,200** | **1,000** | **0** | **1,000** | **71,200** | **70,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **71,500** | **71,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **72,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 70,200 | 1,000 | 0 | 1,000 | 71,200 | 70,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 71,500 | 71,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 72,000 |
| **90** | **Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik** | **80,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **81,000** | **80,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **81,500** | **81,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **82,000** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 80,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 81,000 | 80,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 81,500 | 81,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 82,000 |
| **91** | **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** | **53,300** | **1,000** | **0** | **1,000** | **54,300** | **54,000** | **1,000** | **0** | **1,000** | **55,000** | **54,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **55,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 53,300 | 1,000 | 0 | 1,000 | 54,300 | 54,000 | 1,000 | 0 | 1,000 | 55,000 | 54,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 55,500 |
| **92** | **Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit** | **34,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **35,500** | **34,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **35,500** | **34,500** | **1,000** | **0** | **1,000** | **35,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 34,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 35,500 | 34,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 35,500 | 34,500 | 1,000 | 0 | 1,000 | 35,500 |
| **95** | **Autoriteti për të Drejtën e Informimit** | **77,000** | **2,000** | **0** | **2,000** | **79,000** | **98,000** | **2,000** | **0** | **2,000** | **100,000** | **118,500** | **2,000** | **0** | **2,000** | **120,500** |
| 01110 | Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 77,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 79,000 | 98,000 | 2,000 | 0 | 2,000 | 100,000 | 118,500 | 2,000 | 0 | 2,000 | 120,500 |
| | **TOTALI** | **238,293,920** | **57,145,000** | **34,418,000** | **91,563,000** | **329,856,920** | **245,372,498** | **58,525,000** | **37,560,000** | **96,085,000** | **341,457,498** | **257,732,513** | **61,914,000** | **39,560,000** | **101,474,000** | **359,206,513** |
| | Link Tavanet | 238,293,920 | 57,145,000 | 34,418,000 | 91,563,000 | 329,856,920 | 245,372,498 | 58,525,000 | 37,560,000 | 96,085,000 | 341,457,498 | 257,732,513 | 61,914,000 | 39,560,000 | 101,474,000 | 359,206,513 |
| | Kontroll | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**VENDIM**
**Nr. 526, datë 25.7.2019**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "ROZAFA", SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PRONËN NR. 338, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5012/20", ME VENDNDODHJE NË ÇEKREZ, GRAMSH, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave 'Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve'", dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa", sh.p.k., si qiramarrës, për pronën nr. 338, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 5012/20", me vendndodhje në Çekrez, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 28 960 $m^2$, nga ku sipërfaqe ndërtimore 4 185.48 $m^2$ dhe sipërfaqe funksionale 24 774.52 $m^2$, me nr. pasurie 257/1, z.k. 2167, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, për një periudhë 20 vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# GEN PLAN

## Prona 338 "Ish Rep. Usht. Nr. 5012/20" Çekrez, Gramsh që kërkohet të merret me qira nga Shoqëria "Rozafa" Sh.P.K

MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE
KOLONEL GASPËR **LALA**




SHPJEGUESE

Sip. e Pergjitheshme = **28 960 m2**
Sip. nën objektin 1 60.4x16.6 = 1002.64m2
Sip. nën objektin 2 60.4x16.6 = 1002.64m2
Sip. nën objektin 3 60.4x16.6 = 1002.64m2
Sip. nën objektin 4 60.4x13.1 = 791.24m2
Sip. nën objektin 5 24.3x 8.1 = 196.83m2
Sip. nën objektin 6 17.9x6.55 = 117.24m2
Sip. nën objektin 7 14.0x5.00 = 70.00m2 (Rrënojë)
Sip. nën objektin 8 1.5x1.5 = 2.25m2
**Sip. e përgj. nën objekte = 4 185.48m2**
**Sip. funksionale = 24 774.52m2**

——— Kufiri i repartit

*Shënim:*
Ky genplan u hartua në zbatim të shkresës së Sekretarit të përgjithshëm të MM nr.2092/1, datë 21.03.2018 bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU dhe matjes së objekteve kryera në terren në prani të përfaqsuesit të KM.

Prill 2018

HARTOI
Topograf Ramiz Haxhiu

SHKALLA 1:2500

DREJTORI IGJIU
N/KOL. ARK. FERDI **HYRAJ**

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË

1585317

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit GRAMSH Zona Kadastrale Nr. 2167

Numri i Pasurisë 257/1 Volumi 4 Faqe 70

Adresa e Pasurisë GRAMSH- KOÇAJ

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 28960 m² ([illegible])

Nga kjo : Sa Truall 28960 m² Nga kjo : Sa Ndërtesa 4185,48 m²

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes ______ %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri Atësia Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|
| MINISTRIA E MBROJTJES TIRANE | 100% | TIRANE |

- është pronar i PASURISE Nr. 257/1
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart –
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi –
- kufizimet e pasurisë janë : V 255, 250 , L 367, 270 , J 266/2 , P 186

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 18-04-2018 Nr. 244**

Data e lëshimit të çertifikatës 02-05-2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
( [illegible] )

... nr. 519, Datë 7.11.1994

# KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Vol. 4, Fq. 70

Vijon nga: Vol. ____, Fq. ____

Vijon në: Vol. ____, Fq. ____ deri në: Vol. ____, Fq. ____ -->

PËRFUNDIMTARE (data): __/__/__

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME Z.V.R.P.P. GRAMSH

## A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

Zona Kadastrale: 2167 NR. i PASURISË: 25711

Indeksi i Hartës: K34-113 (119-A)

Adresa e pasurisë: Rrethi GRAMSH / F KOÇAJ

Rr/L ________ P/G ____ Sh ____ K ____ Ap ____

Përshkrim i Veçantë

## B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË

Lloji i Pasurisë: TRUALL | Brenda V.K.N.: Jo --> Po, Ref: ______

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: Sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 28860 m² Ref 0878 | 1. 28860 m² Ref 0878 | 1. 4185,48 m² Ref 0878 |
| 2. ____ m² Ref ____ | 2. ____ m² Ref ____ | 2. ____ m² Ref ____ |
| 3. ____ m² Ref ____ | 3. ____ m² Ref ____ | 3. ____ m² Ref ____ |
| 4. ____ m² Ref ____ | 4. ____ m² Ref ____ | 4. ____ m² Ref ____ |

Per pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuotat e Pjesëmarrjes: ____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat): ______

Vol. ____ Fq. ____

## C - SEKSIONI I PRONËSISË

| Nr. Dok | Data Regjistrim | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikates | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 18.dr.18 | MINISTRIA E MBROJTJES TIRANE | | I | TIRANE | | 02-05-2018 | | [signature] |

Njësohet me origjinalin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPARTI USHTARAK NR. 4001 TIRANË SEKRETARIA

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - perfaqesues i familjes; B - bashkepronar(%)

... SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA

| Nr. Dok | Data e Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. të Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

E- SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj

| Nr. Dok | Data e Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. të Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTESISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME GRAMSH

Gramsh ,me 02/05/2018

Shenim: Kjo kartele ne A4 ka fuqi te njejte me origjinalin e ndodhur ne zyren tone
Ne regjistrin Vol 4 Faqe 70 Zona kadastrale 2164 Bashkia Gramsh

Njësuar me origjinalin

REGJISTRUESI
XHILSON BAJRAMI

Z.V.R.P.P GRAMSH

## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

**ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTESHME GRAMSH**

**REGJISTRUESI**
**XHILSON BAJRAMI**

A-IDENTIFIKIMI I PASURISE 257/1
ZONA KADASTRALE 2167 NR PASURISE ____ VOL 4 FQ 20
INDEKSI I HARTES: k-34-113-[ 119-A ] SHKALLA 1 :2500
ADRESA E PASURISE :RRETHI GRAMSH Q/F Kocaj
LAGJIA :________

B-KUFIZIMET
V- 255, 250
L- 367, 258
J- 266/2
P- 186

C-PRONARI
Ministria e Mbrojtjes
Tiranë

Përputhet me origjinalin

Data: 02 05 2018 ORA : 10
HARTOGRAFI : NERENXA ZHUPANI

ZVRPP GRAMSH



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**ZYRA E NOTERISË TIRANË**
**Nr. ______ Rep.**
**Nr. ______ Kol.**

**DRAFT-KONTRATË QIRAJE**
**Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata**
**Lidhur**

Në Tiranë, sot më datë ________të muajit _______ të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_______________, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë,** përfaqësuar me autorizim të Ministrit, nr. _______ nga Z/Znj. _______________ me detyrë ___________________________, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes __/__/_____, banues në ________, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. ____________, që më poshtë do të quhet "**QIRADHËNËSI**"

**DHE**

**Shoqëria "Rozafa" shpk,** me seli qendrore në Tiranë, me adresë, Rruga "Luigj Gurakuqi" Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Q.K.B me NIPT: K48130547V, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Znj. Lisena Metoshi, e bija e Xhevit, e datëlindjes 30/02/1983, lindur në Elbasan,dhe banues në Elbasan, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimi personal me nr. ________që më poshtë do të quhet "**QIRAMARRËSI**".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr._____, datë __.__.____ të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës dhe Shoqërisë "Rozafa" shpk si Qiramarrës, për pronën shtetërore nr.338 me emërtim "*Ish-Reparti Ushtarak nr.5012/20", me vendndodhje në Çekrez, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 28 960 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 4185.48 m² dhe sipërfaqe funksionale 24 774.52 m² me nr. pasurie 257/1, Zk 2167*", në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
**OBJEKTI I KONTRATËS**

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore *"Spërfaqe të përgjithshme 28 960 m², në të cilën përfshihet 'Ish-Reparti Ushtarak nr.5012/20, me vendndodhje në Çekrez, Gramsh", nga ku sipërfaqe ndërtimore 4185.48 m² dhe sipërfaqe funksionale 24 774.52 m², me nr. pasurie 257/1 Zk 2167",* në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes,sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP Elbasan,

Neni 2
**QËLLIMI I PËRDORIMIT**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për rikonstruksionin e katër kapanoneve me të gjithë infrastrukturën ndihmëse si frigorifere, mjediset ndihmese (gardëroba, shërbimet higjienike),dhe magazina me qëllim ndërtimin e një fabrike për përpunimin e karkalecit, nëpërmjet përpunimit aktiv të mallrave, sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 3
**KOHËZGJATJA**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT**

**4.1** "Qiradhënësi", nëpërmjet , Komandës Mbështetëse si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

**4.2** "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në

çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

**4.3** "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Komandës Mbështetëse, strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

**4.4** "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

**4.5** "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

**4.6** "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT**

**5.1** "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

**5.2** "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin eparashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Legjislacioni Shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

**5.3** "Qiramarrësi" detyrohet që për zhvillimin e aktivitetit, të jetë i paisur me Autorizimin për përpunimin aktiv të mallrave , lëshuar prej institucioneve shtetërore, aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Një kopje e autorizimit, si dhe gjithmonë kur ai përsëritet, duhet të paraqitet edhe te Qiradhënësi.

**5.4** "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

**5.4** "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

**5.5** "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

**5.6** "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

**5.7** "Qiramarrësi", Shoqëria "Rozafa"shpk, sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë për rikonstruksionin total të sipërfaqes ndërtimore, për ta kthyer atë në gjendje pune. Kapanoni 28 propozohet se do të ndërtohet nga e para mbi gjurmët e kapanonit ekzistues, për ta kthyer në repart të përpunimit të gjithë infrastrukturës ndihmëse (gardëroba, shërbimet higjienike), si dhe fabrikën për përpunimin e karkalecit. Kapanonet 18,13,11, do të kthehen në 5 dhoma frigoriferike për ruajtjen e produktit. Investime në makineri e pajisje.

**Financimi i projektit parashikohet në vlerën 62 711 974 lekë (pa tvsh) dhe do të përfundojë brenda vitit 2021, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse.**

Sipas planbiznesit projektit që do të realizohet është si më poshtë:

| | |
|---|---|
| -Fabrikën për përpunimin e karkalecit + mjediset ndihmëse | 30 506 749 lekë |
| -Makineri e Pajisje | 2 500 000 lekë |
| -Ndërtim frigoriferi | 29 705 225 lekë |

Shoqëria, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, brenda vitit 2021 do të investojë në total **62 711 974 lekë (pa tvsh** ) gjashtëdhjetë e dy milion shtatëqinde njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Financimi i projektit dhe investimeve do të bëhet nga fondet e vetë shoqërisë si dhe me kredi bankare.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

**5.8** "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim që, me përfundimin e investimit, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, merr përsipër të punësojë 60 (gjashtëdhjetë ) punonjës të rinj, i cili do të realizohet i ndarë në dy faza:

Brenda vitit 2021 do të ketë të punësuar 20 punonjës dhe nga janari i vitit 2022 e në vijim

kompania do të ketë të punësuar në objektin e kontratës 60 punonjës, numër i cili do të rritet në varësi të ecurisë së prodhimit.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

**5.9**"Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

**5.10** "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me Leje ndërtimi dhe Leje mjedisore nga organet kompetente.

**5.11** "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

**5.12** "Qiramarrësi" detyrohet që nëpërmjet Komandës Mbështetëse, të paraqesë tek "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

**5.13** "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

**5.14** "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

**5.15** Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

**5.16** "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

**5.17** "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me Lejet ose Autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

**5.18** "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

**5.19** Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
**PAGESA E QIRASË**

**6.1**"Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) Euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

**6.2** Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 1 254 240 (një milion e dyqindepesëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzet) lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

**6.3** Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
**PENALITETET**

**7.1** Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

**7.2** Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim

të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
**ZGJIDHJA E KONTRATËS**

**8.1** Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

**8.2** Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

**a.** në marrëveshje midis palëve.

**b.** kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

**c.** kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

**d.** kur "Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata.

**e.** kur prona nevojitet për interes publik.

**f.** kur prona kalon në procedurë privatizimi.

**g.** kur "Qiramarrësi" nuk pajiset me autorizim për përpunim aktiv të mallrave, ose rifreskimin e tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj

**8.3** Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
**PËRGJEGJËSITË E PALËVE**

**9.1** Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

**9.2** Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, dhe 5.8 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Komandës Mbështetëse, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

**9.3** Palët, "Qiramarrësi" dhe Komanda Mbështetëse, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

**9.4** Me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

**9.5** "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhe do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
**DISPOZITAT E FUNDIT**

**10.1** Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

**10.2** Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

**10.3** Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

**10.4** Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

**10.5** Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin

e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter ________________, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

**QIRADHËNËSI**
**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
**Përfaqësuar nga**

**QIRAMARRËSI**
**Shoqëria "Rozafa" sh.p.k.**
**Përfaqësuar nga**

**VENDIM**
**Nr. 527 , datë 25.7.2019**

## PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT INFORMATIK TË MENAXHIMIT FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar (SIMF).

2. SIMF-i përbëhet nga modulet, si më poshtë vijon:

2.1 Moduli i përgatitjes dhe monitorimit të programit buxhetor afatmesëm;

2.2 Moduli i menaxhimit të investimeve publike;

2.3 Moduli i monitorimit të portofolit të projekteve;

2.4 Arkivi elektronik për arkivimin e dokumentacionit mbështetës të transaksioneve buxhetore.

3. SIMF-i ndërvepron me:

3.1 Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;

3.2 Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të njësisë përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri;

3.3 Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat.

4. SIMF-i përmban të dhëna që ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat që gjenerohen në SIMF për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit të njësive të qeverisjes qendrore, specifikisht, si më poshtë:

4.1.1 Të dhëna për tavanet buxhetore në nivel njësie të qeverisjes qendrore dhe programi buxhetor;

4.1.2 Emërtimet dhe kodet e programeve buxhetore;

4.1.3 Të dhënat për projektet e investimeve publike;

4.1.4 Të dhënat për produktet, sasitë dhe kostot përkatëse;

4.1.5 Të dhënat për treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektivi;

4.1.6 Emërtimi dhe kodet e produkteve e të projekteve të investimeve publike;

4.1.7 Të dhëna për raporte financiare menaxheriale, monitoruese dhe statistikore.

4.2 Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë referencë dhe merren nga:

4.2.1 SIFQ:

a) Emërtimi dhe kodet e njësive të qeverisjes së përgjithshme sipas SIFQ-it;

b) Klasifikimi buxhetor, në përputhje me ligjin organik të buxhetit, nr.9936/2008, të ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij;

c) Të dhëna për buxhetin faktik të njësive të qeverisjes së përgjithshme në nivel projekti, produkti, angazhimeve buxhetore dhe artikulli ekonomik.

4.2.2 SIPI/IPSIS:

a) Versioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) Të dhëna lidhur me qëllimin e politikave të programeve buxhetore;

c) Të dhëna lidhur me objektivat specifikë të programeve buxhetore;

ç) Masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

d) Të dhëna për treguesit e performancës në nivel qëllimi;

dh) Të dhëna për treguesit e performancës në nivel objektivi specifik.

4.2.3 EAMIS:

a) Të dhëna për disbursimet e kryera nga donatorët për projektet e investimeve publike me financim të huaj.

5. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

6. Subjektet përgjegjëse të SIMF-it janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues i SIMF-it është ministria përgjegjëse për financat;

b) Institucionet, palë të interesuara, janë: ministria përgjegjëse për financat, ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore qendrore.

7. Dhënës të informacionit janë njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIMF.

8. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SIMF-it është, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIMF-it kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SIMF në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, klasifikimin buxhetor e kontabël dhe të subjekteve të regjistruara;

b) Ministritë e linjës kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIMF;

c) Ministria përgjegjëse për financat ka të drejta administrative mbi SIMF-in në këto role:

i) Administrator;

ii) Raportues;

iii) Auditues;

iv) Zhvillues.

9. Për një periudhë tranzitore prej jo më shumë se një vit kalendarik, që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, lejohet regjistrimi manual në SIMF i të dhënave lidhur me politikat dhe objektivat specifikë të programeve buxhetore deri në sinkronizimin e plotë automatik të të dhënave ndërmjet SIPI-t dhe SIMF-it.

10. Vendimi nr. 82, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit të Programit Buxhetor Afatmesëm", shfuqizohet. Të dhënat e SPBA-së transferohen te SIMF-i brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

11. Ngarkohet ministria përgjegjës për financat dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 528, datë 25.7.2019**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË TË PRONËS ME EMËRTIMIN "QENDRA E SHËRBIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin "Qendra e shërbimit dhe administrimit të mjeteve të transportit", sipas formularit bashkëlidhur vendimit nr. 79, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar".

2. Vendimi nr. 79, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 529, datë 25.7.2019**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA NDËRMARRJA INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË, TE MINISTRIA E BRENDSHME, TË PASURIVE NR. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, ZONA KADASTRALE 8240, ME SIPËRFAQE TOTALE 4122.56 $m^2$, RRUGA "HAMDI PEPA", TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë, te Ministria e Brendshme, të pasurive nr. 3/771, 3/772, 3/773, 3/774, zona kadastrale 8240, me sipërfaqe totale 4122.56 $m^2$, rruga "Hamdi Pepa", sipas dokumentacionit hipotekor bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 1822936

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8240

Numri i Pasurisë 3/772 Volumi 10 Faqe 173

Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.HAMDI PEPA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 1922.00 m2

Nga kjo : Sa Truall 1,922.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 152.19

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPERISE | | | 1/1 | FIER |

- është pronar i pasurisë me numër 3/772
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 27/5/2019 Nr. 53372

Data e lëshimit të çertifikatës 31/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
( MARIGLEN DISHA )

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 10, Fq 173
--> Vijon nga Vol 9, Fq 54
Vijon ne Vol ____, Fq ____ deri ne Vol ____, Fq ____ -->

**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

Zona Kadastrale: 8240 NR.i PASURISE: 3/772

Indeksi i Hartes: TR: T-6

Adresa e Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane

PERFUNDIMTARE (data): 16/12/2011

Rr/L RR.HAMDI PEPA P/G ____ SH ____ K ____ Ap ____

Pershkrim i veçantë:

REPUBLIKA E SHQIPERISE – AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS – TIRANE JUG – DREJTORIA VENDORE

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N.: PO, Ref: PL. RREGULLUES

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë | |
|---|---|---|---|
| 1. 1,922.00 m² Ref. 00002829 | 1. 1,922.00 m² Ref. 00002829 | 1. 152.19 m² Ref. 00002829 | Per pjesen e përbashkët: PALLAT |
| 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ | Kuota e pjesmarrjes: ____ % |
| 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | Nr i Pasurise (pallat) |
| 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | Vol. ____ Faqe ____ |

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002829 | 31/05/2019 | REPUBLIKA E SHQIPERISE | | I | TIRANE | | 31/05/2019 | ND/PAS | |

Shenim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - përfaqesues i familjes, B - bashkepronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002134 | 24.01.2019 | I4_AV | NE ADMINISTRIM TE NDERMARRJES INDUSTRIALE NR 1 | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 3 / 6 /2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë

Në regjistrin Vol 10, Faqe 173, Zona Kadastrale 8240, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI
MARGLEN DISHA

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

*Vula/Firma*

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**

ZONA KADASTRALE 8240
NR. I PASURISE 3/772 VOL 10 FQ 173
INDEKSI I HARTES TR: T-6 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE Rrethi Tirane Q/F Tirane
Rr/L RR.HAMDI PEPA P/G SH K ___ Ap

**B. KUFIZIMET**

V. ____________
L. ____________
J. ____________
P. ____________

**C. PRONARI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

D. Data: 31/05/2019 Ora: 12:39:15PM

X 398822 724
Y 4576592 343

X 398918 635
Y 4576592 343




X 398822 724
Y 4576512 968

X 398918 635
Y 4576512 968

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1811676

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8240

Numri i Pasurisë 3/771 Volumi 10 Faqe 172

Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.HAMDI PEPA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 150.56 m2

Nga kjo : Sa Truall 150.56 Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPERISE | | | 1/1 | FIER |

- është pronar i pasurisë me numër 3/771
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 27/5/2019 Nr. 53372

Data e lëshimit të çertifikatës 31/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
(MARJGLEN DISHA)

*Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

## KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 10, Fq 172

--> Vijon nga Vol 9, Fq 54

Vijon ne Vol ______, Fq ______ deri ne Vol ______, Fq ______ -->

PERFUNDIMTARE (data): 16/12/2011

### A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale 8240 NR.i PASURISE: 3/771

Indeksi i Hartes TR: T-6

Adresa e Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane

Rr/L RR.HAMDI PEPA P/G ____ SH ____ K ____ Ap ____

### B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë TRUALL Brenda V.K.N.: PO, Ref PL. RREGULLUES

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale sa Trual | Nga Sip. Truall sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 150.56 m² Ref. 02829 | 1. 150.56 m² Ref. 02829 | 1. ______ m² Ref. ______ |
| 2. ______ m² Ref. ______ | 2. ______ m² Ref. ______ | 2. ______ m² Ref. ______ |
| 3. ______ m² Ref. ______ | 3. ______ m² Ref. ______ | 3. ______ m² Ref. ______ |
| 4. ______ m² Ref. ______ | 4. ______ m² Ref. ______ | 4. ______ m² Ref. ______ |

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Kuota e pjesmarrjes ______ %

Nr i Pasurise (pallat)

Vol. ____ Faqe ____

Pershkrim i veçantë

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES DREJTORIA VENDORE TIRANE JUG

### C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 000002829 | 31/05/2019 | REPUBLIKA E SHQIPERISE | | I | TIRANE | | 31/05/2019 | ND/PAS | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - përfaqesues i familjes, B - bashkëpronar (%)

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002134 | 24/01/2019 | H_AV | NE ADMINISTRIM TE NDERMARRJES INDUSTRIALE NR 1 | | | |

**E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj**

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 3 / 6 /2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë.

Në regjistrin Vol 10, Faqe 172, Zona Kadastrale 8240, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI
MË GLEN DISHA.

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

*Vula/Firma*

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**

ZONA KADASTRALE 8240
NR. I PASURISE 3/771 VOL 10 FQ 172
INDEKSI I HARTES TR: T-6 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE Rrethi Tirane Q/F Tirane
Rr/L RR.HAMDI PEPA P/G SH K ___Ap

**B. KUFIZIMET**

V.________
L.________
J.________
P.________

**C. PRONARI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

D. Data: 31/05/2019 Ora: 12:36:45PM

X 398831 945
Y 4576621 83

X 398927 856
Y 4576621 83




X 398831 945
Y 4576542 455

X 398927 856
Y 4576542 455

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 1822937

## PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8240

Numri i Pasurisë 3/773 Volumi 10 Faqe 174

Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.HAMDI PEPA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 670.00 m2

Nga kjo : Sa Truall 670.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri Atësia Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPERISE | 1/1 | FIER |

- është pronar i pasurisë me numër 3/773
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 27/5/2019 Nr. 53372

Data e lëshimit të çertifikatës

31/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

(NARGELEN ALISHANI)

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 10, Fq. 174
--> Vijon nga Vol. 9, Fq. 54
Vijon ne Vol. ____, Fq. ____ deri ne Vol. ____, Fq. ____ -->

**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

Zona Kadastrale: 8240 NR i PASURISE: 3/773

Indeksi i Hartes: TR; T-6

Adresa e Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane

PERFUNDIMTARE (data): 16/12/2011

Rr/L RR.HAMDI PEPA P/G ____ SH ____ K ____ Ap ____

Përshkrim i veçantë

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES DREJTORIA VENDORE TIRANË JUG

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N.: PO, Ref PL. RREGULLUES

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 670.00 m² Ref. 02829 | 1. 670.00 m² Ref. 02829 | 1. ____ m² Ref. ____ |
| 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ |
| 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ |
| 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ |

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Kuota e pjesmarrjes ____ %

Nr i Pasurise (pallat): ____

Vol. ____ Faqe ____

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002829 | 31/05/2019 | REPUBLIKA E SHQIPERISE | | I | TIRANE | | 31/05/2019 | ND/PAS | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - perfaqesues i familjes, B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002134 | 24 01 2019 | 14_AV | NE ADMINISTRIM TE NDERMARRJES INDUSTRIALE NR | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 3 / 6 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë

Në regjistrin Vol 10, Faqe 174, Zona Kadastrale 8240, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANE

REGJISTRUES

*Vula/Firma*

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**

ZONA KADASTRALE 8240
NR. I PASURISE 3/773 VOL 10 FQ 174
INDEKSI I HARTES: TR: T-6 SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISE: Rrethi Tirane Q/F Tirane
Rr/L: RR.HAMDI PEPA P/G SH K ___Ap

**B. KUFIZIMET**

V.
L.
J.
P.

**C. PRONARI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

D. Data: 31/05/2019 Ora: 12:40:21PM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1822926

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8240

Numri i Pasurisë 3/774 Volumi 10 Faqe 175

Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.HAMDI PEPA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 1380.00 m2

Nga kjo : Sa Truall 1,380.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPERISE | | | 1/1 | FIER |

- është pronar i pasurisë me numër 3/774
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V ____, L ____, J ____, P ____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga I (të) interesuari (t) më datë 27/5/2019 Nr 53372

Data e lëshimit të çertifikatës 31/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
( MARIGLEN ARSHA )

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 10, Fq 175
--> Vijon nga Vol 9, Fq 54
Vijon ne Vol ___, Fq ___ deri ne Vol ___, Fq ___ -->
PERFUNDIMTARE (data): 16/12/2011

## A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale 8240 NR. i PASURISE 3/774

Indeksi i Hartes TR: T-6

Adresa e Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane

Rr/L RR.HAMDI PEPA P.G ___ SH ___ K ___ Ap ___

## B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N.: PO, Ref PL. RREGULLUES

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale sa Trual | Nga Sip. Truall sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 1,380.00 m² Ref. 02829 | 1. 1,380.00 m² Ref. 02829 | 1. ___ m² Ref. ___ |
| 2. ___ m² Ref. ___ | 2. ___ m² Ref. ___ | 2. ___ m² Ref. ___ |
| 3. ___ m² Ref. ___ | 3. ___ m² Ref. ___ | 3. ___ m² Ref. ___ |
| 4. ___ m² Ref. ___ | 4. ___ m² Ref. ___ | 4. ___ m² Ref. ___ |

Per pjesen e përbashkët: PALLAT
Kuota e pjesmarrjes: ___ %
Nr. i Pasurise (pallat): ___
Vol. ___ Faqe ___

Pershkrim i veçantë

## C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002829 | 31/05/2019 | REPUBLIKA E SHQIPERISE | | I | TIRANE | | 31/05/2019 | ND/PAS | |

Shenim: Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - perfaqesues i familjes; B - bashkepronar

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi | Data e Lesh Çertifikatës | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00002134 | 24 01 2019 | 14_AV | NE ADMINISTRIM TE NDERMARRES INDUSTRIALE NR | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lesh Çertifikatës | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 3 / 6 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 10, Faqe 175, Zona Kadastrale 8240, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI
MARI... DISHA.

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

*Vula/Firma*

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**
ZONA KADASTRALE 8240
NR. I PASURISE 3/774 VOL 10 FQ 175
INDEKSI I HARTES TR: T-6 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE Rrethi Tirane Q/F Tirane
Rr/L: RR.HAMDI PEPA P/G SH K ___ Ap

**B. KUFIZIMET**
V. ____________
L. ____________
J. ____________
P. ____________

**C. PRONARI**
REPUBLIKA E SHQIPERISE

D. Data: 31/05/2019 Ora: 12:41:28PM



**VENDIM**
**Nr. 530, datë 25.7.2019**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 460, DATË 3.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT DHE MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 460, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "b", të pikës 2, shifra 199 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë) lekë bëhet 238 800 000 (dyqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind mijë) lekë.

b) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Me fondet e vëna në dispozicion, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të zhvillojnë procedurat e prokurimit dhe të lidhin kontratat përkatëse për realizimin e projekteve të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 531, datë 25.7.2019**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "STUDIM-PROJEKTIM, MASA INXHINIERIKE BUZUQ-ÇOROVODË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Studim-projektim, masa inxhinierike Buzuq-Çorovodë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH).
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", "mur rrethues" dhe "kultura bujqësore", me një vlerë të përgjithshme prej 1 422 145.31 (një milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tridhjetë e një) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 422 145.31 (një milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tridhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas heqjes së masës së sekuestros konservative dhe pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga ARRSH-ja.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR**
**"STUDIM-PROJEKTIM MASA INXHINERIKE NË AKSIN BUZUQ-ÇOROVODË"**

**Për ndërtimet vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.8.2000, i ndryshuar.**
**Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016;**
**Udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000, "Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së drufrutorve".**

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona Kadastrale | Numri i pasurisë | Sip. totale m² | TOKË TRUALL | | | OBJEKT Murë Rrethues | Vlera e kult. bujq. dhe dru frutorët (lekë) | VLERA TOTALE (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Sipërfaqja shpron. m² | Çmimi (lekë/m²) | Vlera lekë | Vlera sipas preventivit | | | |
| 1 | Bardhyl | Shefki | Aliçka | 2739 | 196/1 | 6997 | 212 | 198 | 41976 | 699912.67 | 58000 | 799888.67 | Sekuestro Konservative |
| 2 | Sokol | Muharrem | Bregu | 2739 | 196/2 | 7083 | 246 | 198 | 48708 | 564548.64 | 9000 | 622256.64 | Sekuestro Konservative |
| **SHUMA TOTALE** | | | | | | | **458** | | **90684** | **1264461.31** | **67000** | **1422145.31** | |

**VENDIM**
**Nr. 532, datë 25.7.2019**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN 'XHEVDET NEPRAVISHTA', KUFIZUAR ME RRUGËN 'AHMET ZOGU', RRUGËN 'MISTO MAME' DHE SHËTITOREN 'KONGRESI', LUSHNJË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim i bllokut të banimit në lagjen 'Xhevdet Nepravishta', kufizuar me rrugën 'Ahmet Zogu', rrugën 'Misto Mame' dhe shëtitoren 'Kongresi', Lushnjë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Lushnjë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 2 754 738 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në masën 2 754 738 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë, të përballohet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues, pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lista emërore e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit "Sistemim i bllokut të banimit në lagjen 'Xhevdet Nepravishta', kufizuar me rrugën 'Ahmet Zogu', rrugën 'Misto Mame' dhe shëtitoren 'Kongresi', Lushnjë";**

| Nr. | Emër, Mbiemër | Lloji i pasurisë | ZK | Nr. i pasurisë | Sip. e truallit m² | Çmimi i truallit lekë/m² | Vlera e truallit | Sip. ndërtesës m² | Çmimi i ndërtimit | Vlera e ndërtesës lekë | Vlera totale truall dhe ndërtesë lekë | Shënime sqaruese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mondi Pëllumb Xhelali | Truall + Ndërtesë | 8571 | 22/31 | 81 | 9709 | 786429 | 81 | | 1968309 | 2754738 | Vërtetim Hipotekor |
| Vlera totale | | | | | | | 786429 | **81** | | 1968309 | 2754738 | |

*Shënim 1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.03.2000*
*2. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë truall", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.*

**VENDIM**
**Nr. 533, datë 25.7.2019**

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR, TË CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT, TË SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 89, pika 2, e 92, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
**1. Qëllimi**
1.1 Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet dhe procedurat për vendosjen nga ERE-ja të detyrimit të shërbimit publik, që zbatohet për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror të klientëve të vegjël, përfshirë klientët familjarë.

1.2 Ky vendim është hartuar në përputhje me ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, duke garantuar që shoqëritë e gazit natyror të veprojnë në përputhje me parimet e këtij ligji, me qëllim arritjen e një tregu konkurrues, të sigurt e të qëndrueshëm, të gazit natyror, nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre.

**2. Objekti**
2.1 Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me:

a) mbrojtjen e shëndetit, të jetës dhe pronës së njerëzve;

b) sigurinë e furnizimit;

c) cilësinë e shërbimit;

ç) tarifat për kryerjen e një detyrimi të shërbimit publik;

d) mbrojtjen e mjedisit;

dh) mbrojtjen e konkurrencës;

e) burimet e rinovueshme të energjisë;

ë) eficiencën e energjisë;

f) çdo rrethanë tjetër që ndikon në interesin publik;

g) ndryshimet klimaterike;

gj) përdorimin e burimeve vendase të gazit natyror.

2.2. Detyrimet specifike të shërbimit publik të një të licencuari në kryerjen e ndonjë prej aktiviteteve të gazit natyror, të përmendura në nënpikën 1.1, të pikës 1, të këtij vendimi, vendosen nga ERE-ja.

2.3. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE-ja, do të përfshihet brenda 1 (një) muaji në termat dhe kushtet e licencës së të licencuarit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren përkatëse të kushteve të licencimit, të miratuar nga ERE-ja.

2.4. Të licencuarit, licencat e të cilëve përfshijnë detyrimet e shërbimit publik, duhet të marrin të gjitha masat, në mënyrë që të përmbushin detyrimet e shërbimit publik në përputhje me këtë vendim dhe vendimin përkatës të ERE-s.

**3. Përkufizimet**
3.1 Çdo term i përdorur në këtë vendim ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhënë në ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

3.2 Në këtë vendim, fjalët: "I licencuari përkatës" nënkuptojnë një të licencuar që kryen aktivitetet e transmetimit, të shpërndarjes ose furnizimit të gazit natyror.

**4. Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik**
4.1 Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe lehtësisht të verifikueshme, duke garantuar barazinë e aksesit për shoqëritë e gazit natyror të vendeve anëtare të BE-së, ose palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, për klientët vendas dhe duke mos penguar hapjen e tregut të gazit natyror dhe të drejtën e furnizuesve të tjerë të gazit natyror për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.

4.2 ERE-ja duhet të argumentojë që vendosja e detyrimit publik është e domosdoshme, jo kufizuese dhe proporcionale.

4.3 Detyrimi i shërbimit publik, për të licencuarin, vendoset duke vlerësuar kapacitetin teknik, financiar dhe organizativ të tij dhe duhet të marrë në konsideratë nëse i njëjti i licencuar po ofron shërbimin publik në të njëjtën zonë, ose për një kategori konsumatorësh në momentin e vendosjes së këtij detyrimi.

4.4 Vendimi, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, duhet:

a) të përcaktojë qartë detyrimet që ka i licencuari;

b) të përcaktojë qartë të licencuarit e gazit natyror, të cilëve u është vendosur detyrimi i shërbimit publik, kur ky detyrim vendoset mbi një ose më shumë subjekte të licencuara, që ushtrojnë aktivitet në sektorin e gazit natyror;

c) të specifikojë natyrën e të drejtave ekskluzive ose të veçanta të caktuara për të licencuarin, duke arsyetuar se pse ato janë të nevojshme;

ç) të përcaktojë kategorinë e klientëve, territorin dhe periudhën për të cilët është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

d) të shoqërohet me një efekt vlerësimi në lidhje me tregun, cilësinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë;

dh) të identifikojë kostot e të licencuarit, ndaj të cilit do të vendoset detyrimi i shërbimit publik;

e) të përcaktojë një mekanizëm transparent dhe jodiskriminues për mënyrën se si do të mbulohen kostot, nëse kostot nuk mbulohen nga tarifa përkatëse;

ë) të bëjë të qartë financimin dhe kriteret për llogaritjen e mbulimit financiar që do të përfitojnë të licencuarit, subjekte të këtij shërbimi publik.

4.5. Në rast vendosjeje të detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, të cilit i shkaktohen kosto shtesë, që nuk janë përfshirë në tarifën e përcaktuar nga ERE-ja, i licencuari do të kompensohet financiarisht apo në forma të tjera të rimbursimit dhe të të drejtave ekskluzive, në përputhje me përcaktimet e pikave 9 e 10, të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

Shpërndarja e kostove shtesë të detyrimeve të shërbimit publik, të shkaktuara ndaj një të licencuari, të vëna në bazë të këtij neni, do të vendoset nga ERE-ja për klientët fundorë, në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente.

Çdo kompensim për të licencuarin, për përmbushjen e detyrimit të ofrimit të shërbimit publik, duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin paraprak nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

4.6. Shpërndarja e këtyre kostove dhe procesi për trajtimin, ndarjen, mbulimin dhe pagesat e tarifave të kërkuara, do të përcaktohet sipas rregullave dhe procedurave të ERE-s.

4.7. I licencuari ka detyrimin e shërbimit publik për sigurimin e shpërndarjes/furnizimit të gazit natyror në një zonë, kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE-ja, sipas ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe duke iu referuar zonave, të cilat janë pjesë e planit rregullues, të miratuar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

II. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK

**5. Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit**

5.1 Shërbimi publik i furnizimit siguron të drejtën e furnizimit me gaz natyror për një kategori të caktuar të klientëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë proporcionale, qartësisht të krahasueshme, transparente dhe me çmime jodiskriminuese.

5.2 Rregullat operacionale për furnizuesit, që kryejnë furnizimin e gazit natyror si një detyrim të shërbimit publik, përcaktohen dhe miratohen nga ERE-ja.

5.3 Klientët familjarë dhe klientët e vegjël jofamiljarë kanë të drejtë të furnizohen me gaz natyror nga furnizuesi që është ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Detyrimi i shërbimit publik të furnizimit vendoset në mënyrë që klientët të furnizohen me gaz natyror nga furnizuesi i shërbimit publik, me çmime të rregulluara, që miratohen nga ERE.

**6. Çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve fundorë nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit**

6.1 Furnizuesi, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, është i detyruar të furnizojë klientët e gazit natyror sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij vendimi, me çmime të rregulluara, në të gjithë territorin e Shqipërisë, në përputhje me këtë vendim.

6.2 Çmimet e rregulluara për shërbimin publik të furnizimit, sipas nënpikës 6.1, të kësaj pike, që miratohen nga ERE-ja në përputhje me nenin 92, të ligjit nr. 102/2015, duhet të pasqyrojnë kostot e arsyeshme të shërbimit.

6.3 Tarifa e furnizimit, sipas kësaj pike, duhet të mbulojë kostot reale të furnizimit me gaz natyror, duke përfshirë investimet e nevojshme kapitale dhe kostot e importeve të gazit, kostot e shërbimeve të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, përfshirë një normë të caktuar të borxheve të këqija.

**7. Klientët në nevojë**

7.1 Klientët familjarë, që kanë fituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 97, të ligjit nr. 102/2015, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit publik të furnizimit sipas kushteve të veçanta të furnizimit, të cilat miratohen nga ERE.

7.2 Të gjitha shpenzimet e bëra nga furnizuesi në lidhje me kushtet e veçanta të furnizimit për këtë kategori klientësh, gjatë një viti, të përcaktuar në nënpikën 7.1, të kësaj pike, mbulohen nga tarifat e atij viti. Në vitin pasardhës mund të bëhet rregullimi i të ardhurave në varësi të performancës së vitit të mëparshëm.

**8. Detyrimi për lidhjen në rrjet**

8.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të përmirësojë dhe të zgjerojë sistemin e shpërndarjes, me qëllim sigurimin e lidhjes së çdo klienti fundor, i cili nuk është i lidhur në sistemin e shpërndarjes, nën termat, kushtet dhe tarifat e vendosura nga ERE-ja.

8.2 Pavarësisht nga detyrimi i përcaktuar në nënpikën 8.1, të kësaj pike, Operatori/ët i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të ketë detyrimin për të ndërtuar apo zgjeruar sistemin e shpërndarjes në një zonë, në të cilën nuk ka ekzistuar rrjet para vendosjes së këtij detyrimi të shërbimit publik, përveç kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE, sipas ligjit nr. 102/2015, si dhe për zonat, të cilat janë pjesë e një plani territorial, kombëtar ose lokal, të miratuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

**9. Cilësia e shërbimit**

9.1 Standardet e cilësisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat e nevojshme të vazhdimësisë së furnizimit në një nivel të qëndrueshëm të presionit, që duhet të plotësohen nga të licencuarit, të cilët kryejnë aktivitetet e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit, duke përfshirë ofruesin e shërbimit publik, të përfshira në rregulloret dhe kodet ekzistuese, do të konsiderohen detyrime të shërbimit publik, të vendosura sipas këtij vendimi.

9.2 Kushtet e cilësisë së furnizimit, të parashikuara në nënpikën 9.1, të kësaj pike, në lidhje me secilin prej të licencuarve, do të miratohen nga ERE-ja, në përputhje me standardet evropiane të shërbimit të furnizimit, duke pasur në konsideratë, por pa u kufizuar në, kërkesat për:

a) sigurimin e shërbimit cilësor të transmetimit të gazit natyror, që lidhet me vazhdimësinë e livrimit dhe cilësinë e gazit natyror që hyn në sistemin e transmetimit dhe ruajtjen e cilësisë së tij deri në daljen nga sistemi;

b) hartimin e një metodologjie për standardet dhe monitorimin e cilësisë së gazit natyror në pikat e hyrjes dhe të daljes të sistemit të transmetimit, si pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar nga ERE-ja;

c) monitorimin në vijimësi të cilësisë së gazit të transmetuar dhe dorëzimin pranë ERE-s të raporteve periodike, në përputhje me metodologjinë e aprovuar;

ç) përcaktimin e vendndodhjeve të kontrollit të cilësisë së gazit;

d) marrjen e të gjitha masave për sigurinë e jetës së njeriut dhe parandalimin e aksidenteve të ndryshme, që mund të ndodhin gjatë transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

**10. Siguria e furnizimit**

10.1 Çdo detyrim i vendosur ndaj një të licencuari që kryen aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes ose furnizimit të gazit natyror në përputhje me rregullat operacionale për furnizuesit që kryejnë furnizimin e gazit natyror si një detyrim të shërbimit publik të përcaktuara dhe të miratuara nga ERE-ja, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik dhe do të trajtohet sipas dispozitave të këtij vendimi.

10.2 Çdo investim i bërë nga shoqëria e transmetimit ose shpërndarjes, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, për kapacitetet e reja të transmetimit ose shpërndarjes, në funksion të plotësimit të kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, do të trajtohet si një detyrim i shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit. Kostot përkatëse mbulohen nëpërmjet tarifave të miratuara nga ERE-ja, në bazë të një metodologjie që miraton ERE lidhur me përcaktimin dhe llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, duke pasur në konsideratë, por pa u kufizuar në, kriteret që kanë të bëjnë me:

a) aplikimin e metodës RoR (*Rate of Return*), që i lejon operatorit të rrjetit të mbulojë kostot e justifikuara;

b) vlerësimin e përcaktimit të kostove të rrjetit, që do të jenë ato aktuale, të amortizimit, të kthimit mbi kapitalin dhe të të ardhurave të zbritshme nga ato të lejuara sipas përcaktimeve përkatëse, që do të bëhen;

c) marrjen në konsideratë nga operatori i rrjetit vetëm të atyre kostove apo komponentëve të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit, njësoj sikur t'i kryente vetë ato, si dhe paraqitjen nga operatori i rrjetit të dokumenteve dhe provave për secilën nga këto kosto;

ç) raportimin pa vonesë te rregullatori nëse ndodhin shpenzime apo të ardhura të jashtëzakonshme.

**11. Rregullat për masat parandaluese dhe të ndërhyrjes në rast aksidenti në transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror**

Me qëllim përcaktimin e masave parandaluese dhe të ndërhyrjes në rast aksidenti që mund të ndodhë gjatë transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, ministria përgjegjëse për energjinë miraton një rregullore, në përgatitjen e së cilës merret në konsideratë edhe paketa e rregullave teknike për sektorin e gazit natyror, të cilat janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

III. DISPOZITA TË TJERA DHE TË FUNDIT

**12. Monitorimi dhe raportimi**

12.1 ERE monitoron zbatimin e detyrimeve të shërbimit publik nga ana e të licencuarve përkatës, sipas këtij vendimi, subjekte të detyrimeve të shërbimit publik, si dhe të termave e kushteve të licencave përkatëse.

12.2 Jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, ERE miraton raportin vjetor, të hartuar nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për veprimtarinë e furnizimit të realizuar si detyrim i shërbimit publik për vitin paraardhës. Ky raport vihet në dispozicion të Këshillit të Ministrave dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

12.3 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ERE informojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, për të gjitha masat e vendosura për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sipas këtij vendimi, ndikimin e tyre të mundshëm në hapjen e tregut të gazit natyror dhe nëse këto masa janë në përputhje me direktivën 2009/73/EC.

12.4 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ERE njoftojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë periodikisht, të paktën çdo dy vjet, për çdo ndryshim të kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

**13. Organi përgjegjës për zbatimin e vendimit**

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 534, datë 25.7.2019

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 42, DATË 16.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i shkronjës "b", të pikës 1, të kreut III, "Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", të rregullores që i bashkëlidhet vendimit nr. 42, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 535, datë 25.7.2019**

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE TË VEPRAVE NDIHMËSE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TOPOJË, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "*MAX ENERGY*", SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse në njësinë administrative Topojë, qarku Fier, nga shoqëria "*Max Energy*", sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: "*Max Energy*", sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS i aplikuesit: L77003205H;

c) Tipi i centralit: eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 MW;

d) Numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në MW: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 MW;

dh) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 muajve, nga marrja e lejes së ndërtimit;

e) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: njësia administrative Topojë, qarku Fier;

ë) Afati i miratimit të ndërtimit: 48 muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

f) Koordinatat e tokës: sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synimin që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit;

gj) Shoqëria "*Max Energy*", sh.p.k. ka detyrimin që:

i) të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii) të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii) të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "*Max Energy*", sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv) t'i japë falas, në formë *royalty*, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sasinë e energjisë elektrike (por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë). Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit;

v) të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKSI 1

Koordinatat e tokës

Shoqëria "*MAX ENERGY*", sh.p.k. është pajisur me një kontratë qiraje për një tokë pa frut (ranishte), me sipërfaqe të përgjithshme 37 300 m$^2$, e ndodhur në fshatin Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, qarku Fier, me numër pasurie 286/5, zona kadastrale 3358, volum 10, faqe 85, me kufizime nga veriu me pasurinë 561, nga lindja me pasurinë 565, nga jugu me pasurinë 286/6 dhe nga perëndimi me pasurinë 363, me koordinata si më poshtë:

| X | Y |
|---|---|
| 363446.530 | 4517253.923 |
| 363926.088 | 4517253.923 |
| 363446.530 | 4516857.048 |
| 363926.088 | 4516857.048 |




**VENDIM**
**Nr. 536, datë 25.7.2019**

**PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË PËR VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE LIGJORE, VERIFIKIMIN E FIGURËS E TË PASURISË SË KANDIDATËVE JOMAGJISTRATË PËR POZICIONIN E INSPEKTORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 289, pikat 3 e 4 , 283, pikat 3 e 4, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me procedurat që Inspektori i Lartë i Drejtësisë (Inspektori) zhvillon për verifikimin e figurës e të pasurisë, si edhe të kushteve e të kritereve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët jomagjistratë për t'u zgjedhur në pozicionet vakante për inspektorë.

2. Këto rregulla kanë për qëllim realizimin e këtij procedure duke u bazuar në meritat e kandidatëve jomagjistratë dhe duke respektuar parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, të transparencës, të informimit, të drejtësisë, të paanësisë, të proporcionalitetit, të mbrojtjes të të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit gjatë procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve e të kritereve ligjore si dhe verifikimin e figurës e të pasurisë.

II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT

A. Fillimi i procedurës së verifikimit

3. Procedura administrative e verifikimit të pasurisë të kandidatëve jomagjistratë kryhet nga Inspektori dhe fillon brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve jomagjistratë.

4. Inspektori verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve jomagjistratë. Inspektori, pasi përjashton nga konkurrimi kandidatët që nuk plotësojnë kushtet ligjore, rendit kandidatët e tjerë, sipas meritës, duke zbatuar, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, kërkesat e nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

B. Të drejtat e kandidatit jomagjistrat

5. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga Inspektori për verifikimin e plotësimit të kushteve e të kritereve ligjore si dhe të verifikimit të figurës e të pasurisë së kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke respektuar kërkesat e legjislacionit në

fuqi për informacionin e klasifikuar dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

6. Kryesisht apo mbi kërkesën e Inspektorit, kandidati jomagjistrat ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

7. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Inspektorin. Pas këtij njoftimi, Inspektori vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit jomagjistrat. Akti i Inspektorit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit jomagjistrat dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

C. Njoftimet

8. Njoftimet e Inspektorit drejtuar kandidatit jomagjistrat gjatë procedurës së verifikimit bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike të deklaruar për këtë qëllim nga kandidati, pranë Inspektorit.

9. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit jomagjistrat drejtuar Inspektorit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose në adresën elektronike të tij, e cila i është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave.

10. Kandidati jomagjistrat, në ditën e thirrjes nga Inspektori për t'u pajisur me formularët e deklarimit dhe të autorizimeve, sipas ligjit dhe këtij vendimi, deklaron me shkrim adresën postare dhe adresën elektronike për efekt të komunikimit dhe njoftimeve me Inspektorin. Njëkohësisht, për efekt të pranimit të njoftimeve që dërgon, kandidati jomagjistrat njihet me adresat zyrtare elektronike të Inspektorit.

11. Kandidati jomagjistrat ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Inspektorin për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës postare dhe elektronike të deklaruar.

III. PROCEDURA ADMINISTRATIVE E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE JOMAGJISTRATË

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të Inspektorit

12. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve jomagjistratë fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

13. Inspektori ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale e verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore nga secili kandidat jomagjistrat.

14. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, për secilin kandidat jomagjistrat, Inspektori realizon procedurat standarde, si më poshtë vijon:

a) Pajisjen e kandidatit jomagjistrat me formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë";

b) Pajisjen e kandidatit jomagjistrat me formularin për vetëdeklarim sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

c)Pajisjen e kandidatit jomagjistrat me formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

ç) Pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale;

d) Pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit;

dh)Pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar nga kandidati të formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës;

e) Dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

15. Inspektori njofton, menjëherë, zyrtarisht kandidatin jomagjistrat për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturës dhe për detyrimin për t'u

paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga ajo e njoftimit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për t'u pajisur me formularët e deklarimeve dhe të autorizimeve të përcaktuara në pikën 14, të këtij vendimi. Në pamundësi objektive për t'u paraqitur brenda afatit dhjetëditor, kandidati jomagjistrat njofton menjëherë Inspektorin duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Inspektori, kur motivet janë të justifikuara, i cakton kandidatit jomagjistrat një afat të ri të arsyeshëm për t'u paraqitur pranë zyrës së Inspektorit.

16. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat jomagjistrat, Inspektori konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës së Inspektorit. Kur i vlerëson të justifikuara motivet e paraqitura nga kandidati jomagjistrat për mospërmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, Inspektori i cakton një afat të ri të arsyeshëm.

17. Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 15 e 16 të këtij vendimi, Inspektori procedon me dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati jomagjistrat, institucionet publike dhe subjektet private në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

18. Në procedurën e verifikimit, Inspektori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat jomagjistrat, formularët e deklarimeve të plotësuara, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatëve jomagjistratë, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Inspektorit që vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore për kandidim.

19. Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me vendimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, Inspektori njofton kandidatin jomagjistrat të verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati pesëmbëdhjetëditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm, sipas vlerësimit të kandidatit jomagjistrat;

b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjese të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe të kritereve përkatëse ligjore, për të cilat Inspektori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Në rast se informacioni është i klasifikuar "sekret shtetëror" të zbatohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

20. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, kandidati jomagjistrat njofton menjëherë Inspektorin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, Inspektori i cakton kandidatit jomagjistrat një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

21. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 15 deri 20 të këtij vendimi, kandidati jomagjistrat nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Inspektorit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, Inspektori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara.

22. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore të kandidimit, Inspektori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me shqyrtimin e çështjes.

23. Nëse vlerëson që kandidati jomagjistrat nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, Inspektori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.

24. Kur kandidati jomagjistrat njofton tërheqjen nga kandidimi, Inspektori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të

verifikimit të kandidatit jomagjistrat të tërhequr.

25. Inspektori vendos për të gjitha çështjet që parashtrohen në relacion me vendim të arsyetuar.

26. Në rastin kur pas shqyrtimit të akteve që përmban dosja e kandidatit jomagjistrat të verifikuar, Inspektori vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 15 deri në 20 të këtij vendimi, kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e marrjes në dijeni të materialit të dërguar nga Inspektori.

27. Pas shqyrtimit të akteve, Inspektori vendos:

a) lejimin e kandidimit;

b) ndalimin e kandidimit;

c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

28. Inspektori vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati jomagjistrat nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklarimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati jomagjistrat;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si dhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Inspektorit.

29. Inspektori vendos ndalimin e kandidimit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të tij gjatë procedurës së verifikimit, kandidati jomagjistrat përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, të autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit, të parashikuara nga ligji.

B. Akti i verifikimit. E drejta e ankimit

30. Vendimi për procedurën e verifikimit të kandidatit jomagjistrat është i arsyetuar dhe hartohet sipas kërkesave të nenit 99, të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

31. Vendimi i arsyetuar i njoftohet kandidatit jomagjistrat, i cili ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

C. Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit

32. Vendimet e Inspektorit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

33. Në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë publikohen edhe:

a) lista e kandidatëve jomagjistratë për të cilët është vendosur ndalimi i kandidimit;

b) lista e kandidatëve jomagjistratë për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit.

IV. PROCEDURA TË VEÇANTA PËR VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE JOMAGJISTRATË

34. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionet A, B dhe C të kësaj ndarjeje, për zhvillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, të figurës dhe të kushteve të tjera ligjore të kandidatit jomagjistrat, zbatohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në krerët II dhe III, të këtij vendimi.

A. Verifikimi i pasurisë së kandidatit jomagjistrat

35. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati jomagjistrat paraqitet në zyrën e Inspektorit për të tërhequr, kundrejt nënshkrimit, kopjen fizike të formularit "Deklaratë e pasurisë dhe e interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë", të hartuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 3/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, si edhe informacionin mbi lidhjen elektronike zyrtare të ILDKPKI-së në të cilën kandidati jomagjistrat mund të marrë dhe të plotësojë në rrugë elektronike këtë deklaratë, përfshirë udhëzimin përkatës për mënyrën e plotësimit të saj.

36. Njëkohësisht, kandidati jomagjistrat pajiset me formularët e autorizimeve për Inspektorin që të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga kandidati jomagjistrat dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së Inspektorit, jo më vonë

se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e marrjes në dorëzim.

37. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit dhe e dorëzimit nga kandidatët jomagjistratë dhe personat e lidhur të autorizimeve, sipas pikës 36, të këtij vendimi:

a) Inspektori i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve jomagjistratë që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";

b) Inspektori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit jomagjistrat dhe të personave të lidhur.

38. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja në dorëzim e formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati jomagjistrat e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin justifikues/shoqërues. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4, pika 2 e vijues të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar.

39. ILDKPKI-ja njofton menjëherë Inspektorin në rastin kur kandidati jomagjistrat nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë.

40. ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë të të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e kësaj deklarate pranë ILDKPKI-së.

41. Nëse gjatë 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve para asaj të paraqitjes së deklaratës, kandidati jomagjistrat i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, si edhe në rastin kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Inspektorit kopjen e deklarimit të bërë nga kandidati jomagjistrat, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklarimit. Në çdo rast, Inspektori kryen veprimet e parashikuara nga shkronja "b" e pikës 37 të këtij vendimi.

42. Pavarësisht parashikimit të pikës 41 të këtij vendimi, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit jomagjistrat, Inspektori vihet në dijeni, nga burime të ligjshme, për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit jomagjistrat, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit, sipas parashikimeve të neneve 3/1 dhe 25/1, pika 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar.

43. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Inspektorit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe të personave të lidhur.

44. Inspektori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit jomagjistrat dhe të personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike dhe private, sipas kërkesës të tij.

45. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe të nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, Inspektori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati jomagjistrat, i cili, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë këto shpjegime dhe dokumente mbështetëse drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin pesëmbëdhjetëditor, kandidati jomagjistrat njofton menjëherë Inspektorin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, Inspektori i cakton kandidatit jomagjistrat një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

46. Në rastin kur në procedurën e verifikimit të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklarimet e kandidatit jomagjistrat, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të

sjella nga subjektet publike e private, Inspektori ka të drejtën të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse.

47. Ekspertët e fushës përkatëse të institucioneve shtetërore thirren nga Inspektori sipas fushës së njohurive. Në rastet kur ekspertiza nuk mbulohet nga institucionet shtetërore, ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuara për fushën përkatëse, në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

48. Ekspertët caktohen nga Inspektori. Shpenzimet për pagesën e ekspertëve mbulohen nga buxheti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

49. Kandidati jomagjistrat që verifikohet, njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Inspektori. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja dijeni, kandidati jomagjistrat ka të drejtë të paraqesë me shkrim kërkesën e motivuar pranë Inspektorit, duke treguar shkaqet për gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Në çdo rast, Inspektori vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, sipas legjislacionit në fuqi.

50. Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimit të betimit, sipas udhëzimeve të Inspektorit, eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatisë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

51. Kur e vlerëson, Inspektori mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime. Në vendimin e arsyetuar të Inspektorit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.

52. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati jomagjistrat, Inspektori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, për sa i përket verifikimit të pasurisë.

53. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati jomagjistrat, Inspektori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

54. Ndalimi i kandidimit vendoset nga Inspektori, në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati jomagjistrat:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) ka kryer deklarim të rremë;

ç) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

55. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe në rastet kur kandidati jomagjistrat:

a) ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t'u pajisur me formularin e deklaratës së pasurisë ose nuk e ka plotësuar dhe depozituar atë pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit;

b) ka refuzuar nënshkrimin e autorizimeve të kërkuara nga Inspektori për verifikimin e pasurisë.

B. Verifikimi i integritetit të kandidatit jomagjistrat

56. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e Inspektorit për të tërhequr, kundrejt nënshkrimit:

a) kopjen fizike të formularit për vetëdeklarim, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

b) kopjen fizike të formularit të aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", sipas ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

c) informacionin mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të cilën kandidati jomagjistrat mund të marrë dhe të plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, këta formularë deklarimi;

ç) formularin e autorizimit për Inspektorin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 283, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të kryejë verifikimin pranë organeve kompetente sipas ligjit, të të dhënave mbi figurën e kandidatit jomagjistrat.

57. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë)) ditë nga marrja e formularëve të parashikuar në pikën 56, të këtij vendimi, kandidati jomagjistrat i dorëzon ato të plotësuara në zyrën e Inspektorit.

58. Vetëdeklarimi i kandidatit jomagjistrat, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

59. Inspektori e përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të plotësuar nga kandidati jomagjistrat, në Prokurorinë e Përgjithshme.

60. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.

61. Gjithashtu, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të kandidatit jomagjistrat, të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Inspektori kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave "a" dhe "c", të pikës 66, të këtij vendimi, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

62. Formulari i aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", sipas nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i plotësuar nga kandidati jomagjistrat, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

63. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe të nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, Inspektori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati jomagjistrat, i cili, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetëse. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin pesëmbëdhjetëditor, kandidati jomagjistrat njofton menjëherë Inspektorin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, Inspektori i cakton kandidatit jomagjistrat një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

64. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, Inspektori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit të kandidatit jomagjistrat.

65. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, Inspektori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit.

66. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion konfirmohet se kandidati jomagjistrat:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

c) është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

67. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur:

a) kandidati jomagjistrat ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t'u pajisur me formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" ose me formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", sipas ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", apo nuk i ka plotësuar dhe depozituar ato;

b) kandidati jomagjistrat ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Inspektorin që të kryejë verifikimin në organet kompetente, sipas ligjit, lidhur me të dhënat që lidhen integritetin e kandidatit.

C. Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit

68. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati jomagjistrat pajiset me formularin e autorizimit për Inspektorin që të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore të kandidimit, të përcaktuara në pikën 6, të nenit 209, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Autorizimi i nënshkruar rregullisht nga kandidati jomagjistrat depozitohet pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

69. Inspektori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati jomagjistrat për të vlerësuar nëse, për efekt të verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë dhe nuk gjenden elemente që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij.

70. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë pasaktësi ose edhe elemente që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, Inspektori mund të kërkojë:

a) informacione nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati jomagjistrat, i cili, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetëse. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin pesëmbëdhjetëditor, kandidati jomagjistrat njofton menjëherë Inspektorin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, Inspektori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

71. Nëse nga gjetjet e procesit të verifikimit Inspektori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

72. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati jomagjistrat, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, Inspektori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve e kritereve të tjera ligjore.

73. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati jomagjistrat, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati jomagjistrat nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të parashikuara nga pika 6, e nenit 209, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

74. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur kandidati jomagjistrat ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Inspektorin që të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

A. Fillimi dhe procedura e verifikimit dhe e përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë, pas krijimit të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

75. Çdo jurist i interesuar për pozicionin e inspektorit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda 1 (një) muaji nga krijimi i zyrës së Inspektorit të Lartë, dorëzon aplikimin pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

76. Inspektori verifikon plotësimin e kushteve dhe të kritereve ligjore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë.

77. Njoftimi zyrtar i Inspektorit për fillimin e procedurave ligjore të verifikimit të kandidaturave, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", shpallet menjëherë në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

78. Gjithashtu, ky njoftim zyrtar i dërgohet individualisht secilit kandidat jomagjistrat në adresën elektronike të deklaruar prej tij në dokumentacionin e kandidimit të depozituar pranë Inspektorit.

79. Inspektori paraqet kërkesë për informacion për verifikimin e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe të çdo shkaku tjetër përjashtues, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokurorisë, organeve publike financiare, Byrosë Kombëtare të Hetimit, shërbimeve shtetërore informative, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe çdo organi disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e mëparshme të punës të kandidatit.

Nëse vlerësohet e nevojshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacione shtesë nga institucione të tjera.

80. Inspektori, për kandidatin jomagjistrat bën vlerësimin e aftësive profesionale dhe morale, sipas kritereve të parashikuara për pozicionin e inspektorit.

81. Inspektori miraton një raport të arsyetuar me shkrim, bazuar në rezultatet e deklaratave të pasurisë, të vlerësimit të figurës, si dhe në përmbushjen e kushteve e të kritereve ligjore, të parashikuara ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", për kandidatin jomagjistrat.

B. Rregulla kalimtare për përmbylljen e procedurave të verifikimit

82. Procedurat e vlerësimit dhe të renditjes së kandidaturave fillojnë pasi Inspektori të ketë përfunduar procedurat e verifikimit dhe të ketë vendosur për lejimin ose ndalimin e kandidimit të të gjithë kandidatëve jomagjistratë.

83. Ngarkohen Inspektori i Lartë i Drejtësisë si dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 537, datë 25.7.2019

## PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË LABORATORËVE TË DIAGNOSTIKIMIT TË PARAZITËVE TË DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 105/2016 "Për mbrojtjen e bimëve", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, nga varësia e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Universiteti Bujqësor, Tiranë) ta Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, të tokës bujqësore, trojeve, godinave dhe objekteve të tjera të ndërtuara mbi to, si dhe kalimin kapital të pasurisë tjetër shtetërore të luajtshme.

2. Kalimet të bëhen duke iu referuar vlerave në bilancin kontabël në datën e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim bëhen nga një komision i përbashkët, i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Universiteti Bujqësor, Tiranë,) dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Me të njëjtën procedurë, sipas pikës 2, të dorëzohen edhe arkivat shkencorë, financiarë si dhe çdo dokumentacion tjetër arkivor.

4. Laboratorët e diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve organizohen në Sektorin e Shëndetit të Bimëve, në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve (DMB) pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Tiranë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si qendër reference kombëtare për problemet që lidhen me mbrojtjen e bimëve.

5. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve pranë ISUV-it ka për detyrë:

a) të monitorojë parazitët karantinorë, të përcaktojë statusin e tyre, metodat e kontrollit karantinor dhe të njoftojë ministrinë;

b) të bëjë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e parazitëve, duke përcaktuar edhe masat e kontrollit të tyre;

c) të bëjë provat biologjike-agronomike të PMB-ve gjatë procedurës për regjistrimin e tyre, kur kërkohet një gjë e tillë;

ç) të hartojë praktikat e mira të mbrojtjes së bimëve dhe kriteret e mbrojtjes së integruar;

d) të hartojë kriteret e përgjithshme dhe procedurat për miratimin e laboratorëve të kontrollit të mbrojtjes së bimëve;

dh) të bëjë vlerësimin e laboratorëve të kontrollit, me qëllim miratimin e tyre si laboratorë të miratuar për kryerjen e analizave të kontrolleve zyrtare;

e) të bashkërendojë punën dhe të japë mbështetjen, përfshirë trajnimet dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;

ë) të organizojë teste paralele të mostrave të standardizuara dhe marrjen pjesë në to, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të miratuar të kontrollit;

f) të garantojë përdorimin e një sistemi të brendshëm, në përputhje me standardet e kërkuara nga laboratorët e miratuar të kontrollit.

6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës për zhvillimin e praktikave mësimore nga ana e studentëve të tij në mënyrë të përhershme pranë këtyre laboratorëve.

7. Zbatimi i pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, të përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2019.

8. Zbatimi i pikës 4, të këtij vendimi, fillon nga data 1 janar 2020.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr.540, datë 25.7.2019

## PËR MIRATIMIN E MASAVE TË NEVOJSHME PËR MBAJTJEN E PËRGJEGJËSIVE TË ZGJERUARA TË PRODHUESIT NGA ÇDO PERSON FIZIK A JURIDIK, QË PRODHON, PËRPUNON, TRAJTON DHE SHET LËKURË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i masave të nevojshme, që çdo person fizik/juridik, i cili prodhon, përpunon, trajton lëkurën dhe e shet (prodhuesi), mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut dhe në përputhje me parimin "ndotësi paguan", të përcaktuar në ligjin nr. 10431/2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar.

2. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i masave që duhet të respektojnë operatorët e instalimeve për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, konkretisht për:

a) parandalimin e mbetjeve të gjeneruara nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës;

b) procedurat, teknikat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës;

c) trajtimin e ujërave të ndotura industriale përpara shkarkimeve të tyre në gropa septike dhe trupat e tjerë ujorë pritës;

ç) trajtimin e diferencuar të kimikateve të rrezikshme dhe shmangien e shkarkimit të tyre në mjedis;

d) aplikimin e teknologjive më të mira në dispozicion (TMD), që bëjnë të mundur ripërdorimin e ujërave të ndotura industriale, me qëllim pakësimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis;

dh) sigurimin e kushteve dhe pajisjeve për të mbrojtur mjedisin, shëndetin e punonjësve dhe të njerëzve, që bien në kontakt me mbetjet e gjeneruara nga këto instalime;

e) përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit për minimizimin e mbetjeve që gjenerohen nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës, ripërdorimin, rikuperimin, riciklimin dhe trajtimin specifik të diferencuar të mbetjeve organike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbi baza profesionale;

ë) përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit për menaxhimin e mbetjeve të lëkurës, që teprojnë pas trajtimit dhe përpunimit teknologjik të tyre, mbi baza profesionale.

3. Ky vendim zbatohet nga çdo prodhues / operator, i cili është përgjegjës për një instalim për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, i cili përfshihet në veprimtaritë "instalimet për trajtimet me regjie dhe prodhimin e lëkurës", referuar përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit. Ky vendim nuk zbatohet për operatorët e instalimeve, të cilët përdorin lëkurën si lëndë të parë për prodhimin e këpucëve, çantave dhe veshje apo aksesorëve të tjerë prej lëkure.

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr.10431/2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin dhe përshkruajnë proceset, si më poshtë vijon:

a) "çgëlqerizimi", procesi që konsiston në uljen e pH alkalin dhe neutralizimin e tij, me qëllim rigjallërimin e lëkurës;

b) "Depilimi", procesi i kombinuar i shpërbërjes së qimeve dhe hidrolizës alkaline;

c) "Gëlqerosja", procesi teknologjik i gëlqerosjes, që konsiston në trajtimin e lëkurës me tretësirë të ngopur të kalciumit (Ca) nga 5 -15%, që kryhet pas procesit të heqjes së qimeve;

ç) "Ngjyrimi", procesi i ngjyrosjes të lëkurës me ngjyra, të cilat i jepen lëkurës sipas shijeve dhe kërkesave të tregut;

d) "Pasregjia", procesi i trajtimit të lëkurës, pas procesit të regjjes, i cili synon të përmirësojë vlerat e lëkurës;

dh)"Piklimi", procesi që synon uljen e pH, nëpërmjet shtimit të acideve;

e) "Prodhues", personi juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton dhe shet produkte të lëkurës si lëndë e parë;

ë)"Regjia bimore", procesi i trajtimit të lëkurës me esenca bimore, për të siguruar te lëkura qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj kalbjes;

f) "Regjia kromike", procesi që nënkupton trajtimin për regjie të lëkurës, duke përdorur kripëra të kromit (Cr);

g) "Regjia", procesi i trajtimit që synon transformimin e lëkurës pas çgëlqerosjes dhe trajtimit të saj me acid për të pasur një produkt të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj lagështisë dhe kalbjes nga agjentët mikrobikë;

gj) "Skarifikimi", procesi i heqjes së mishrave nga ana e brendshme e lëkurës;

h) "Tharja", një proces i largimit të lagështisë së tepërt të lëkurës;

i) "Zbutja", procesi për t'i dhënë lëkurës një lagështi dhe elasticitet të nevojshëm dhe të manovrueshëm.

5. Proceset teknologjike të parashikuara sipas përkufizimeve të pikës 4, të këtij kreu, janë procese, të cilat prodhuesi duhet t'i përshkruajë në aplikimin për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe aplikimit për t'u pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, si dhe të deklarojë shkarkimet e mundshme në ajër, ujë, tokë dhe sasinë e mbetjeve, që do të gjenerohen për secilin proces, si dhe masat që do të merren specifikisht për shkarkimet e ndryshme gjatë proceseve të ndryshme.

II. KRITERET E VENDNDODHJES SË INSTALIMEVE

1. Instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme për vendndodhjen e tyre:

a) Të jenë brenda zonave industriale të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore;

b) Kur nuk ka zona të miratuara për zhvillimin e aktiviteteve industriale, instalimet:

i) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura dhe zonat e rekreacionit;

ii) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga zonat me rëndësi për biodiversitetin, të miratuara nga autoritetet përkatëse;

iii) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga zonat urbane;

iv) të jenë të zhvendosura rreth 1 000 m larg shtretërve të lumenjve.

III. MBETJET QË GJENEROHEN NGA INSTALIMET E PËRPUNIMIT DHE TRAJTIMIT TË LËKURËS

1. Mbetjet që gjenerohen gjatë procesit teknologjik të trajtimit të lëkurës janë, si më poshtë vijon:

a) Mbetje të qimeve ose leshit, të gjeneruara gjatë proceseve të pastrimit të lëkurës, para trajtimit të tyre;

b) Mbetje nga pjesët e trupit të kafshëve, si thundrat, brirët, pjesë nga qafa, koka, bishti etj.;

c) Mbetje nga pastrimi dhe heqja e dhjamërave të lëkurës;

ç) Mbetje të kripërave të kalciumit (NaCl), që dalin gjatë trajtimit dhe regjjes së lëkurës;

d) Mbetje nga përbërës të taninës, të cilat janë rezultat i trajtimit me këto kimikate për të rritur fortësinë dhe rezistencën e lëkurës;

dh) Mbetje nga kripërat e kromit, që përdoren në trajtimet kimike të lëkurës, që kanë për qëllim mbrojtjen e produkteve të lëkurës nga dëmtuesit dhe brejtësit;

e) Mbetje nga kripërat e fosfateve.

IV. MASAT E NEVOJSHME PËR INSTALI-MET E GRUMBULLIMIT, PËR-PUNIMIT DHE TRAJTIMIT TË LËKURËS

1. Prodhuesi që operon në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës duhet të zhvillojë aktivitetin e tij vetëm pasi të jetë pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, për çdo instalim.

2. Prodhuesi që operon në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës duhet të operojë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e kimikateve të rrezikshme, për menaxhimin e ujërave të ndotura industriale, për menaxhimin e shkarkimeve në ajër, për menaxhimin e mbetjeve organike dhe të ngurta dhe për menaxhimin e zhurmës në mjedis.

3. Këto instalime, përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, duhet të marrin masa edhe për zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga konventa mbi tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër (CITES). Produktet e lëkurës ose gëzofët nga speciet e listuara në anekset e kësaj konvente janë subjekt i kufizimeve apo i detyrimit për marrjen e lejeve/certifikatave për eksportin / importin/ rieksportin e tyre në vendet që janë palë të konventës CITES.

V. MASAT E NEVOJSHME PËR PARA-NDALIMIN E RREZIQEVE

1. Rreziqet potenciale gjatë procesit teknologjik vijnë nga:

a) kimikatet e përdorura në procesin e regjjes, të cilat mund të kenë veti të rrezikshme, të tilla si: ndezshmëri, toksicitet, potencial korroziv dhe potencial oksidimi;

b) agjentët biologjikë, që mund të vijnë nga bakteret, kërpudhat, merimangat dhe parazitët, që mund të jenë të pranishëm në lëkurë ose mund të formohen gjatë procesit të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës;

c) ndotja e ujërave dhe tokës nga kloridet, taninet, kromi, sulfatet dhe sulfatet trivalent, si dhe kimikatet e tjera organike;

ç) zjarret ose shpërthimet në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit apo të tharjes, të cilët mund të përdorin një sërë materialesh të ndezshme. Shpërthimet ose zjarret mund të shkaktojnë dëme jo vetëm në instalime por edhe në mjediset përreth, si dhe në kontaminimin e ujërave, tokës dhe ajrit;

d) ndotja e ajrit dhe çlirimi i substancave të rrezikshme, si VOCs/ tretës organikë dhe sulfur hidrogjeni në ajër, të cilët rrezikojnë mjedisin.

2. Masat që duhet të merren për të shmangur dhe parandaluar rreziqet e sipërpërmendura janë, si më poshtë vijon:

a) Masa për menaxhimin e kimikateve të rrezikshme, referuar ligjit për menaxhimin e kimikateve dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) Masa për menaxhimin e ujërave të ndotura industriale, referuar ligjit nr.9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur", të ndryshuar, dhe vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse";

c) Masa për menaxhimin e shkarkimeve në ajër, referuar vendimit nr.908, datë 21.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime";

ç) Masa për menaxhimin e mbetjeve organike, sipas përcaktimeve të vendimit nr.608, datë

17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre" dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

VI. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE TË RREZIKSHME

1. Për të shmangur ndotjen e mjedisit dhe rrezikimin e shëndetit të njeriut, kimikatet, të cilat përdoren gjatë procesit teknologjik të prodhimit, trajtimit, regjjes dhe përpunimit të lëkurës dhe që janë të kategorizuara si të rrezikshme, sipas vendimit nr.489, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) e të kritereve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve", duhet që:

a) të jenë të etiketuara me simbole të përcaktuara, sipas kërkesave të vendimit nr.488, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve";

b) kimikatet që shkaktojnë reaksione në prani të kimikateve të tjera të mos ruhen në të njëjtin vend. Udhëzimet për pajtueshmërinë e kimikateve të ndryshme mund të merren nga të dhënat në etiketat dhe certifikatat e këtyre produkteve;

c) të magazinohen në ambiente të siguruara, të mbyllura, të mbuluara dhe të shtruara me beton, për të shmangur depërtimin e ujërave të shirave në vendet e ruajtjes së tyre apo ndotjen e tokës dhe ujërave sipërfaqësore në rast aksidentesh. Instalimet duhet të kenë sisteme kullimi që të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr.9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", ose në një impiant grumbullimi, që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.

ç) të instalohen pajisje për dhënie alarmi, në rastet e shkarkimeve të depozitave nga tejmbushja apo të prezencës së gazeve toksike në ambientet e instalimeve.

2. Prodhuesi që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës të mbajë një regjistër për sasinë e kimikateve të përdorura gjatë proceseve teknologjike në instalim.

VII. MASAT E NEVOJSHME PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA

1. Instalimet e përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës, që shkarkojnë ujëra të ndotura me përmbajtje të kimikateve dhe baktereve, që vijnë si rezultat i përdorimit të solucioneve të ndryshme gjatë procesit teknologjik, duhet të kenë:

a) sisteme të trajtimit të ujërave të ndotura industriale, si pjesë e proceseve teknologjike të prodhimit, të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës, para shkarkimeve në gropat septike apo vende të tjera të lejuara;

b) kontratë me instalime të pajisura me lejen e mjedisit përkatëse për shkarkimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane për proceset teknologjike që nuk përdorin kimikate apo që nuk gjenerojnë ujëra të ndotura industriale;

c) sisteme për trajtimin e ujërave të ndotura industriale që përmbushin kërkesat dhe standardet e përcaktuara në ligjin përkatës për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, si dhe në vendimin nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".

2. Ujërat e ndotura industriale, pasi trajtohen dhe neutralizohen, mund të shkarkohen në gropa septike apo në trupat ujorë pritës, nëse i përmbushin normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta, sipas vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".

3. Shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, që janë pjesë e proceseve teknologjike të trajtimit me kimikate dhe me përmbajtje mbi normat kufi të përcaktuara për kromin, fosfatet dhe nitratet, sipas normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta, duhet të grumbullohen dhe të trajtohen në vaskat dekantuese përpara shkarkimit të tyre.

4. Ujërat e ndotura industriale, pas trajtimit mjedisor në impiante të posaçme trajtimi të licencuara dhe të pajisura me lejen përkatëse mjedisore, shkarkohen në gropa septike.

5. Prodhuesi që operon në instalimet për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës duhet të mbajë një regjistër, të shoqëruar me evidencat përkatëse, për sasinë e ujërave të ndotura që janë grumbulluar, trajtuar dhe shkarkuar nga instalimi.

VIII. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR DHE ZHURMAVE

1. Gazet që shkarkohen në atmosferë gjatë procesit të prodhimit, të trajtimit dhe të përpunimit të lëkurës janë, si më poshtë vijon:

a) Sulfidi i hidrogjenit, i cili çlirohet gjatë procesit të depilimit dhe është shumë toksik dhe i ndezshëm;

b) Komponimet organike të paqëndrueshme (VOCs) mund të çlirohen nga të gjitha proceset që përdorin tretës organikë;

c) Pluhuri dhe aromat, të cilat janë shqetësuese për zonat përreth instalimit.

2. Për të shmangur ndotjen e ajrit, shkarkimet e gazeve në ajër nga instalimet duhet të jenë brenda vlerave kufi, të përcaktuara në vendimin nr. 435, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër", si dhe pikat e shkarkimit të gazeve duhet të pajisen me sisteme ventilimi dhe trajtimi të shkarkimeve të gazeve.

3. Sistemet e ventilimit dhe të filtrave për kapjen e gazeve duhet të përmbushin kërkesat dhe standardet e përcaktuara në legjislacion në fuqi për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Shkarkimet e pluhurave dhe aromave në ajër nga instalimet duhet të jenë brenda vlerave kufi, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për cilësinë e ajrit.

5. Transportimi, lëvizjet brenda instalimit, si dhe përpunimi e trajtimi i lëkurës nëpërmjet proceseve teknologjike në këto instalime, duhet të bëhen në mënyrë të kontrolluar dhe profesionale, duke minimizuar kështu zhurmat dhe dridhjet.

6. Makineritë dhe pajisjet e përdorura në instalim duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin shoqërues që tregon të dhënat për fuqinë e zhurmës që lëshon. Këto makineri dhe pajisje duhet të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen gjatë procesit të punës në kushte të përshtatshme dhe efiçente për të mos kaluar indikatorët e përcaktuar të zhurmës, me qëllim minimizimin e zhurmave.

7. Për instalimet e prodhimit, të grumbullimit, të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës duhet të ketë një procedurë të dokumentuar, ku të përshkruhet si shmangen ose minimizohen zhurmat dhe vibrimet, të cilat duhet të jenë brenda indikatorëve të përcaktuar në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

8. Prodhuesi duhet të marrë masa që instalimi për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurëve të jetë i rrethuar nga një brez i gjelbër, me lartësi minimumi 2 (dy) metra, me qëllim reduktimin e aromave të pakëndshme dhe uljen e nivelit të zhurmave, si dhe me një distancë të mjaftueshme nga objekti për të shmangur rrezikun e zjarrit.

9. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, duhet të mbajë një regjistër për sasinë e gazeve, pluhurave të shkarkuara dhe nivelin e zhurmave të lëshuara nga instalimi, si dhe çdo ndërhyrje apo mirëmbajtje në sistemet e ventilimit dhe të ndërrimit të filtrave.

IX. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE ORGANIKE DHE TË NGURTA

1. Mbetjet e krijuara nga procesi teknologjik si: mbetje të lëkurës, dhjamëra, qime, mbetje të tjera shtazore, të cilësuara si mbetje organike dhe komponimet e kromit dhe të sulfurit, të cilësuara si të ngurta, trajtohen të diferencuara në instalime për trajtimin e këtyre mbetjeve, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Instalimet duhet të pajisen me lejen përkatëse mjedisore për trajtimin e mbetjeve të ngurta, sipas specifikës së tyre, deri në fazën e tyre përfundimtare që pushojnë së qeni mbetje.

3. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, mban një regjistër për sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe duhet të ketë një plan për mënyrën e trajtimit të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

X. PËRGJEGJËSIA FINANCIARE E PRODHUESIT

1. Çdo person fizik/juridik, i cili prodhon, përpunon, trajton lëkurën dhe e shet, (prodhuesi), mbi baza profesionale, mban përgjegjësi financiare për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Operatorët, që e përdorin lëkurën si lëndë të parë për prodhimin e këpucëve, çantave, veshjeve dhe/apo aksesorëve të tjerë prej lëkure, kanë

përgjegjësi të lidhin marrëveshje/kontratë për trajtimin e mbetjeve, që krijohen nga procesi me prodhuesin ose me një operator tjetër të licencuar, që kryen operacione trajtimi të mbetjeve të lëkurës, sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet.

3. Në rastin kur kontrata/marrëveshja e parashikuar në pikën 2, të këtij kreu, lidhet me një operator tjetër të licencuar, që kryen operacione trajtimi të mbetjeve të lëkurës, kjo kontratë i vihet në dispozicion prodhuesit dhe përbën kusht për marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet prodhuesit dhe operatorit që përdor lëkurën si lëndë të parë.

XI. NDALIME

1. Në zbatim të këtij vendimi ndalohet:

a) përzierja e ujërave larëse me ujërat e ndotura industriale, veçanërisht e atyre me përmbajtje substancash të rrezikshme;

b) shkarkimi i ujërave të ndotura në gropa septike, pa iu nënshtruar trajtimit paraprak të tyre, brenda normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta, sipas vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse";

c) depozitimi i mbetjeve organike në landfillet e mbetjeve urbane;

ç) përdorimi i kimikateve të paregjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit për menaxhimin e kimikateve;

d) instalimi dhe vënia në punë e veprimtarive, makinerive dhe impianteve të prodhimit të lëkurës, në mjedise të brendshme dhe të jashtme, pa zbatuar masa parandaluese e mbrojtëse, zhurma e të cilave kapërcen nivelet kufi.

2. Në rast se konstatohet kryerja e aktiviteteve të ndaluara, të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, ndërmerren masat ligjore dhe administrative për ndërprerjen, pezullimin, mbylljen apo sekuestrimin e instalimit, sipas shkallës së shkeljes, referuar dispozitave ligjore, përkatësisht: nenit 69, të ligjit nr.10431/2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar; nenit 29, të ligjit nr.10448/2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar; nenit 23, të ligjit nr.9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", të ndryshuar; nenit 62, të ligjit nr.10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar; nenit 40, të ligjit nr.27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve"; nenit 32, të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".

XII. Monitorimi, raportimi dhe INSPEKTIMI

1. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, duhet të ketë sistem të miratuar për monitorimin dhe raportimin e rezultateve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas kërkesave të përcaktuara në lejen e mjedisit.

2. Sistemi i monitorimit përfshin, të paktën, si më poshtë vijon:

a) Kimikatet e përdorura;

b) Monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura;

c) Monitorimin e shkarkimeve në ajër;

ç) Monitorimin e mbetjeve organike dhe të ngurta që krijohen dhe mënyra e menaxhimit të tyre;

d) Monitorimin e zhurmave të shkaktuara nga instalimi;

dh) Sasitë e lëkurës të grumbulluara, të përpunuara, të trajtuara, të prodhuara e të shitura, si dhe llojet e tyre.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin inspekton të gjithë operatorët ekonomikë të instalimeve të grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës, (prodhuesit) që veprimtaria e tyre është në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e integruar të mbetjeve, lejet e mjedisit dhe për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

4. Prodhuesit, të cilët janë subjekt i këtij vendimi, i vënë në dispozicion inspektoratit shtetëror përgjegjës për mjedisin të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në instalim.

XIII. DISPOZITA KALIMTARE

1. Të gjithë operatorët ekonomikë e një instalimi ekzistues për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, të fillojnë të marrin të gjitha masat teknike, ligjore, rregullatore, që instalimi të jetë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

2. Të gjithë operatorët ekonomikë të një instalimi ekzistues për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për

rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

3. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij kreu, dhe në çdo rast, kur nga strukturat e kontrollit, të monitorimit dhe të inspektimit konstatohet mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi, ndërmerren masat ligjore dhe administrative për ndërprerjen, pezullimin, mbylljen apo sekuestrimin e instalimit, sipas shkallës së shkeljes.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton kushtet e lejes së mjedisit për instalimet e reja të grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës si dhe rishikon kushtet e lejeve ekzistuese të mjedisit për instalimet ekzistuese, mbështetur në kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 541, datë 25.7.2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 137, DATË 28.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR EVIDENTIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE GJATË BREGDETIT SHQIPTAR, ME QËLLIM INVESTIMIN NË TURIZMIN BREGDETAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 137, datë 28.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 11, shtohen pikat 11.1 dhe 11.2, si më poshtë vijon:

"11.1 Task-Forca monitoron, mbikëqyr dhe ndjek në kohë reale të gjitha ndryshimet, përditësimet, regjistrimet, si dhe çdo veprim tjetër të kryer nga organet shtetërore në lidhje më pasuritë e paluajtshme shtetërore, të cilat ndodhen brenda fashës 1.5 km nga vija bregdetare.

11.2 Institucionet dhe organet e përmendura në pikën 11, të këtij vendimi, vënë në dijeni Task-Forcën në lidhje me të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet që do të ndodhin në statusin juridik të pasurive të paluajtshme shtetërore përgjatë vijës bregdetare, sipas pikës 11.1 të këtij vendimi.".

2. Në pikën 12, fjalët: "… deri në datën 31 korrik 2019." ndryshohen në: "… deri në datën 31 dhjetor 2019.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 543, datë 17.7.2019**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURISË NR. 1/644, ZONA KADASTRALE NR. 8210, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA BASHKIA TIRANË TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PASURISË NR. 5/626, ZONA KADASTRALE NR. 8160, TIRANË, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 670, DATË 7.8.2013, DHE NR. 219, DATË 21.3.2017, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë

22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë nr. 1/644, zona kadastrale 8210, në administrim të Ministrisë së Drejtësisë, me emërtimin "truall", me sipërfaqe 7,564 $m^2$ dhe vendndodhje në rrugën "Beniamin Kruta", Tiranë, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, për sipërfaqen prej 4 900 $m^2$, pjesë e pasurisë nr. 5/626, në zonën kadastrale 8160, me emërtimin "truall", me vendndodhje në Qytetin Studenti, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë), të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

4. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë), të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", hiqet sipërfaqja prej 4 900 $m^2$ pjesë e pasurisë me nr. 5/626, zona kadastrale 8160, me emërtimin "truall", me vendndodhje në Qytetin Studenti, Tiranë.

5. Në titullin dhe përmbajtjen e vendimit nr. 670, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët: "... për Dhomën Kombëtare të Avokatisë ...", "... dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë ..." dhe "... për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë ...", hiqen.

6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kryen saktësimin e të dhënave hartografike, të numrave të pasurisë dhe të kufijve të pasurisë së paluajtshme që i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij vendimi, për Dhomën e Avokatisë të Shqipërisë, dhe procedurat e regjistrimit të ndryshimit të përgjegjësisë së administrimit në regjistrin e pronave të paluajtshme.

7. Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## PLAN RILEVIMI

| PERGATITI | IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| Emri: STUDIO "GEO-BRUNA"<br>Licensa Nr. TZ0645/3 Date 13 / 12 / 2018<br>Data e pergatitjes: 03 / 04 / 2019<br>STUDIO "GEO-BRUNA" Vleresues Pasurish te Paluajtshme Topograf Gjeodezi Kolaudim Projektim Zbatim Ing. Brunilda LAZE Nipt: L12323006 E<br>Vula/Firma | ZONA KADASTRALE 8160<br>NR. PASURISE 5/626 VOL.46 FQ.198<br>INDEKSI I HARTES TR; S-14;R-14<br>SHKALLA 1:2500<br>ADRESA E PASURISE:, Rrethi TIRANE.<br>Q/ TIRANE Rr/L<br>P/G SH K Ap<br>KERKUES: BASHKIA TIRANE<br>NDARJE PASURIE |

— Pasuria nr. 5/626, vol 46, faqe 198, indeks harte TR; S-14;R-14, zone kadastrale 8160 me siperfaqe totale S = 96.019m² Truall do te ndahet si me poshte:

— Siperfaqe $S_1$ = 4.900m² truall

— Siperfaqe $S_2$ = 91.119m² truall



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 1823327

### PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8210

Numri i Pasurisë 1/645 Volumi 39 Faqe 91

Adresa e Pasurisë TIRANE Rruga BENIAMIN KRUTA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 14504.50 m2

Nga kjo : Sa Truall 14,504.50 Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| SHTET | | | 1 / 1 | TIRANË |

- është pronar i pasurisë me numër 1/645
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë** 28/3/2019 **Nr** 29897

Data e lëshimit të çertifikatës
29/3/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
ELION SEMANAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME Z.V.R.P.P TIRANË

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 39, Fq. 91

--> Vijon nga: Vol 29, Fq. 107

Vijon në: Vol ______, Fq. ______ deri në: Vol ______, Fq. ______ --->

## A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: **8210** NR.i PASURISE: **1/645**

Indeksi i Hartes: **TR; M-6**

**Adresa e Pasurisë:** Rrethi **TIRANE** Q/F **TIRANE**

**PERFUNDIMTARE** (data): **20/10/2012**

Rr/L **BENIAMIN KRUTA** P/G ____ SH ___ K ___ Ap ___

Përshkrim i veçantë:

## B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: **TRUALL** Brenda V.K.N. : **PO**, Ref: **PL.RREG**

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. **14,504.50** $m^2$ Ref. **00014641** | 1. **14,504.50** $m^2$ Ref. **00014641** | 1. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 2. ______ $m^2$ Ref. ______ | 2. ______ $m^2$ Ref. ______ | 2. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ |

Per pjesen e përbashkët :
PALLAT
Kuota e pjesmarrjes: %
Nr i Pasurise (pallat):
Vol ____ Faqe ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME Z.V.R.P.P TIRANË

## C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00014641 | 29/03/2019 | SHTET | | | | I | TIRANË | | 29/03/2019 | T.Nd pasurie | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

| ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| REGJISTRUES Elion Semanaj | ZONA KADASTRALE 8210<br>NR. I PASURISE: 1/645 VOL 39 FQ 91<br>INDEKSI I HARTES: TR: M-6 SHKALLA: 1:1760<br>ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE O/F TIRANE<br>Rr/L: BENIAMIN KRUTA P/G SH K Ap |
| | B. KUFIZIMET<br>V.<br>L.<br>J.<br>P.<br>C. PRONARI<br>SHTET |
| REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME Z.V.R.P.P TIRANË<br>Vula/Firma | D. Data: 29/03/2019 Ora: 2:50:08PM |

X: 399071.663
Y: 4578664.238

X: 399409.267
Y: 4578664.238




X: 399071.663
Y: 4578384.842

X: 399409.267
Y: 4578384.842

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË
### ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 1823326
### PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit: Z.V.R.P.P. TIRANË — Zona Kadastrale Nr. 8210

Numri i Pasurisë: 1/644 — Volumi 39 — Faqe 90

Adresa e Pasurisë: TIRANE Rruga BENIAMIN KRUTA

Lloji i Pasurisë: TRUALL

Sipërfaqja Totale: 7564.00 m2

Nga kjo : Sa Truall: 7,564.00 — Nga kjo : Sa Ndërtesa: -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes: - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| SHTET | | | 1 / 1 | TIRANË |

- është pronar i: pasurisë me numër 1/644
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V ____, L ____, J ____, P ____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 28/3/2019 Nr. 29897

Data e lëshimit të çertifikatës: 29/3/2019

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
( ELION SEMANAJ )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME Z.V.R.P.P TIRANË

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

**KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**

Vol 39, Fq. 90

--> Vijon nga: Vol 29, Fq. 107

Vijon në: Vol ______, Fq. ______ deri në: Vol ______, Fq. ______ --->

**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

Zona Kadastrale: **8210** NR.i PASURISE: **1/644**

Indeksi i Hartes: **TR; M-6**

Adresa e Pasurisë: Rrethi **TIRANE** Q/F **TIRANE**

PERFUNDIMTARE (data): **20/10/2012**

Rr/L **BENIAMIN KRUTA** P/G ____ SH ___ K ___ Ap ___

Përshkrim i veçantë:

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: **TRUALL** Brenda V.K.N. : **PO** , Ref : **PL.RREG**

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. **7,564.00** $m^2$ Ref. **00014641** | 1. **7,564.00** $m^2$ Ref. **00014641** | 1. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 2. ______ $m^2$ Ref. ______ | 2. ______ $m^2$ Ref. ______ | 2. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ |
| 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ |

Per pjesen e përbashkët : PALLAT

Kuota e pjesës/uriše ______

Nr i Pasurise (pallat): ______

Vol ____ Faqe ____

REPUBLIKA E SHQIPERISE – ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME – Z.V.R.P.P TIRANË

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00014641 | 29/03/2019 | SHTET | | I | TIRANË | | 29/03/2019 | T.Nd pasurie | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

Elion Semanaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
Z.V.R.P.P TIRANË

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8210
NR. I PASURISE 1/644 VOL 39 FQ 90
INDEKSI I HARTES TR; M-6 SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE
Rr/L: BENIAMIN KRUTA P/G SH K ___Ap

B. KUFIZIMET

V. ____________
L. ____________
J. ____________
P. ____________

C. PRONARI

SHTET

D. Data: 29/03/2019 Ora: 2:48:01PM

X: 398861.891
Y: 4578813.322

X: 399341.448
Y: 4578813.322




X: 398861.891
Y: 4578416.447

X: 399341.448
Y: 4578416.447

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME**

**ÇERTIFIKATË** 1826098

**PËR VËRTETIM PRONËSIE**

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8160

Numri i Pasurisë 5/626 Volumi 46 Faqe 198

Adresa e Pasurisë TIRANË Rruga Q.STUDENTI

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 96019.00 m2

Nga kjo : Sa Truall 96,019.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA TIRANE | – | - | 1/1 | TIRANË |

- është pronar i pasurisë me numër 5/626
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V ______, L ______, J ______, P ______

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë** 8/11/2018 **Nr.** 109056

Data e lëshimit të çertifikatës 8/11/2018

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUES

ELION SENANAJ

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 588 lekë